



Situata demografike, sociale dhe riprodhuese në Kosov?
Rezultatet e anketës për ekonomi shtëpiake
Korrik 2003

Janar 2005

Falenderimet:

Punetorët e ESK-ës kanë luajtur rol kyç në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për këtë anketë. Analizimi dhe komentimi I të dhënave është kompletuar nga konsulentët e emëruar nga UNFPA-ja: Laurie Lewis dhe Gilles Roger. Raporti final ishte kompletuar nga Rhiannon James UNFPA.

Kjo anketë nuk do të realizohej pa ndihmën financiare të Qeverisë Suedeze.



ESK

rr. Zenel Salihu nr. 4

Prishtinë

Tel: +381 38 23 51 11

Fax: +381 38 23 50 33

UNFPA

UN House, 14 Pejton City

38000 Prishtine

Tel: +381 38 249 087

Fax: +381 38 249 089

E mail: kosovo.office@unfpa.org

Harta e Kosovës



Përmbajtja

Lista e tabelave.....Error! Bookmark not defined.

Kapitulli 1: Qëllimet dhe Organizimi i Anketës	8
1.2 Nevoja për Anketën e Dytë Demografike, Sociale dhe të Shëndetit Riprodhues.....	8
1.2 Qëllimet e Anketës.....	9
1.3 Disenjimi i Anketës.....	9
Kapitulli 2: Popullsia, Banimi dhe Ekonomitë Familjare	12
2.1 Popullsia sipas Moshës dhe Gjinisë	12
2.2 Struktura e ekonomive familjare	15
2.3 Karakteristikat e kryetarit të ekonomisë familjare	16
2.4 Karakteristikat e banimit	17
2.5 Treguesit e varfërisë	19
Kapitulli 3: Karakteristikat Personale të Popullsisë së Anketuar	21
3.1 Karakteristikat biografike të të anketuarëve	21
3.2 Gjendja Martesore	23
3.3 Niveli arsimor i të anketuarve	25
3.5 Punësimi	28
Kapitulli 4: Fertiliteti	34
4.1 Fertiliteti aktual	34
4.2 Fëmijët e lindur dhe që jetojnë	36
4.3 Preferencat për fertilitet	37
Kapitulli 5: Vdekshmëria	41
5.1 Sfondi dhe vlerësimi i kualitetit të të dhënave	41
5.2 Vdekjet në ekonomi familjare në 12 muajt e kaluar	42
5.3 Llogaritjet e vdekshmërisë nga fëmijët që kanë vdekur	43
5.4 Shkalla e mbijetesës së fëmijëve të lindur– shkallat e rregulluara.....	43
5.5 Përfundimet për llogaritjet e vdekshmërisë	45
Kapitulli 6: Kontraceptivët	46
6.1 Njohuria për kontraceptivë	46
6.2 Përdorim i kontraceptivëve	48
6.3 Përdorimi aktual i kontraceptivëve	48
6.4 Metoda e përzier kontrceptive	50
6.5 Përdorimi aktual për nga karakteristikat personale	51
6.6 Përdorimi aktual për nga gjendja e grave	52
6.7 Metoda e ushqimit me gji (LAM)	54
6.8 Burimi i kontraceptivëve	55
6.9 Efektet e anësore të kontraceptivëve.....	56

Kapitull 7: Çështjet e shëndetit riprodhues dhe shëndetësor	57
7.1 Planifikimi i familjes.....	57
7.2 Vizitat shëndetësore	58
7.3 Informatat për shëndetin riprodhues nga burimet tjera	59
7.4 HIV/AIDS në Kosovë	60
7.5 Njohuria për HIV/AIDS dhe metodat e parandalimit të HIV-it	60
Kapitull 8: Migrimi	63
8.1 Migrimi i brendshëm.....	63
8.2 Migruesit që janë kthyer nga jashtë	66
8.3 Anëtarët e familjes që nuk janë prezent	67
Kapitulli 9: Nevoja për hulumtime të tutjeshme	68
Referencat	69
Aneksi A: Te dhenat kualitative ne tabela.....	69
Aneksi B: Pyetsoret.....	70

Lista e tabelave

Tabela 2.1 Popullsia sipas moshës, gjinisë dhe vendbanimit.....	12
Tabela 2.2 Përbërja e Ekonomisë Familjare	15
Tabela 2.3 Kryetarët e ekonomive familjare sipas gjendjes martesore, vendbanimit dhe gjinisë.	17
Tabela 2.4 Tipi i banimit dhe gjendja e zotërimit sipas vendbanimit.....	18
Table 2.5 Pajisjet e ekonomisë familjare sipas vendbanimit	19
Tabela 2.6 Posedimi i asetëve nga ekonomitë familjare sipas vendbanimit	20
Tabela 2.7 Të ardhurat e ekonomisë familjare sipas vendbanimit	20
Tabela 3.1 Karakteristikat personale të anketuarëve	22
Tabela 3.2 Moshë mesatare e beqarisë me rastin e martesës sipas vendbanimit dhe gjinisë	23
Tabela 3.3 Arritjet në shkollim sipas karakteristikave personale: gratë	25
Tabela 3.4 Arritjet në shkollim sipas informatave karakteristike: burrat	26
Tabela 3.5 Personat që aktualisht ndjekin shkollimin ose studiojnë sipas grupmoshës dhe gjinisë	26
Tabela 3.6 Personat që aktualisht ndjekin shkollimin sipas grupmoshës, gjinisë dhe vendbanimit	27
Tabela 3.7: Norma e analfabetizimit sipas gjinise dhe vendbanimit	28
Tabela 3.8: Norma e analfabetizimit sipas gjinise dhe	28
Tabela 3.9 Gjendja e aktivitetit ekonomik.....	29
Tabela 3.10 Shkallët e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore, 1999 dhe 2003.....	29
Tabela 3.11 Shpërndarja në përqindje e popullsisë të punësuar të moshës 15-64 vjeç sipas gjinisë dhe vendbanimit.	30
Tabela 3.12 Profesionet e grave	32
Tabela 3.13 Profesionet e burrave	33
Tabela 4.1 Fertiliteti aktual.....	35
Tabela 4.2 Fëmijët e lindur.....	36
Tabela 4.3 Krahasimi në mes të TFR-së dhe CEB-it.....	37
Tabela 4.4 Numrim ideal i fëmijëve.....	37
Tabela 4.5 Numri ideal i fëmijëve dhe preferencat për gjini dhe vendbanim.....	39
Tabela 5.1 Vdekjet në vitet e fundit	42
Tabela 5.2 Raporti i fëmijëve të lindur që kanë vdekur, për nga moshë e nënës dhe vendi i banimit	43
Tabela 6.1 Njohuria për metoda kontraceptive	46
Tabela 6.2 Njohuria për metodat kontraceptive për nga karakteristikat personale	47
Tabela 6.3 Përdorimi i kontraceptivëve.....	48
Tabela 6.4 Përdorimi aktual i kontraceptivëve.....	49
Tabela 6.5 Përdorimi aktual i kontraceptivëve për nga karakteristikat personale	52
Tabela 6.6 Vendimi për të përdorur kontraceptivë.....	53
Tabela 6.7 Vendimi për përdorimin e kontraceptivëve për nga karakteristikat personale.....	53
Tabela 6.8 Burimi i metodave moderne kontraceptive	55
Tabela 6.9 Paraqitja e efekteve anësore të gratë që përdorin metoda kontraceptive	56
Tabela 7.1 Diskutim për planifikim të familjes.....	57
Tabela 7.2 Vizitat shëndetësore	59
Tabela 7.3 Njohja për HIV.....	60
Tabela 7.4 Njohuria e mënyrave për të parandaluar HIV-in.....	62
Tabela 8.1 Migruesit për jetë për nga regjioni, 2003.....	64

Tabela 8.2 Migrimi i brendshëm në pesë vite për personat mbi pesë vjeç	65
Tabela 8.3 Numri i migruarëve hyrës që kanë ardhë nga regjioni ose komuna tjetër.....	66
Tabela 8.4 Shteti i banimit para pesë vitesh për banorët kthyes	67
Tabela 8.5 Anëtarët e raportuar familjar jo-prezent	67

Kapitulli 1: Qëllimet dhe Organizimi i Anketës

1.2 Nevoja për Anketën e Dytë Demografike, Sociale dhe të Shëndetit Riprodhues

Pas konfliktit të vitit 1999, ka pasur nevojë kritike për të dhëna ekonomike, sociale dhe demografike për të ndihmuar në rindërtimin dhe zhvillimin e Kosovës. Si përgjigje në këtë nevojë, UNFPA-ja në partneritet me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe Entin e Statistikës së Kosovës (ESK), me financim prej Qeverisë Kanadeze, ka realizuar anketën e parë *Demografike, Socio-Ekonomike dhe të Shëndetit Riprodhues* në tërë Kosovën të bazuar në ekonomi familjare prej Nëntorit 1999 gjer në Shkurt 2000.

Anketa e vitit 1999 ofroi një fotografi çasit të besueshme të gjendjes. Pavarësisht nga problemet në disenjimin e anketës dhe anketimit, të realizuara në kohëra të vështira, janë arritur disa rezultate të çmuara. Për shumicën e popullsisë të Evropës, për shembull, plakja tani është çështje kritike, pasi që përqindja e popullsisë së moshës mbi 60 vjeç po rritet shpejtë si rezultat rënies së shkallës së lindjeve dhe vdekshmërisë më të ulët. Regjimi i lartë i vdekshmërisë dhe fertilitetit në Kosovë në vitet para anketës, për dallim, ka rezultuar në një shpërndarje të popullsisë në të cilën një e treta ishin nën moshën 15 vjeç dhe gjysma nën moshën 25 vjeç. Të dhënat për popullsinë nga kjo anketë gjithashtu treguan se një numër i madh i kosovarëve në moshë të punës ishin jashtë Kosovës në kohën e anketës, dhe paratë e dërguara paraqisnin kontribut të çmueshëm për ekonominë lokale. Raporti i anketës theksoi një shkallë të ulët të pjesëmarrjes së grave në ekonomi, mosbarazinë që vazhdonte në mes meshkujve dhe femrave në arsimim, dhe varshmërinë financiare të shumicës së grave, të gjitha këto janë rezultate të cilat janë konfirmuar më vonë nga studimet e ndërmarra nga Ministria e Arsimit dhe Banka Botërore. Rezultatet e anketës, gjithashtu, kanë treguar se më pak se 10 përqind e grave dhe burrave të moshave riprodhuese përdorin kontraceptivët modern.

Në mungesë të të dhënave tjera, rezultatet nga anketa e vitit 1999 vazdojnë të përdoren si bazë për formulimin e politikave dhe programeve brenda ministrive relevante, OJQ-ve, agjencive multilaterale dhe bilaterale. Disa prej informatave vazhdojnë të jenë relevante, siç është numri i madh i të rinjve që kërkojnë mundësi arsimit dhe punësimit. Ministria e Shëndetit dhe komuniteti i donatorëve janë të vetëdijshëm për dëshirën për familje më të vogla dhe kuptojnë nevojën urgjente për zgjedhje të shtuar të kontraceptivëve për individ dhe çifte. Çfarëdo të ndodh me fertilitetin e grave, ka brenga se do të vazhdoj të shtohen lindjet pasi që numër i madh i adoleshentëve kosovar po hyjnë në moshat riprodhuese.

Megjithatë, disa prej rezultateve të vitit 1999 janë të një saktësie të panjohur, duke pasur parasysh rrethanat e vështira të anketës. Kështu, përveç mundësisë për të përfshirë tema të reja, gjithashtu është menduar se një anketë e re do të ofronte rezultate më të sakta.

Në tetor të vitit 2002, Banka Botërore ka rekomanduar¹ një Anketë të plotë Shëndetësore dhe Demografike. Gjithashtu, gjerësisht është e pranuar nevoja për regjistrimin e plotë të popullsisë, dhe ligji për regjistrimin është nënshkruar në dhejtor të vitit 2004 por për shkak të një numri të arsyeve logjistike, teknike dhe financiare, nuk është i mundshëm realizimi i regjistrimit të plotë para vitit 2006. Prandaj, UNFPA si agjenci ekzekutive me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze (SIDA), në qershor të vitit 2003 ka realizuar anketën e quajtur “Anketa Demografike, Sociale dhe e Shëndetit Riprodhues në Kosovë”.

1.2 Qëllimet e Anketës

Duke pasur parasysh ndryshimet e shpejta që po ngjajnë në Kosovë, mungesën e të dhënave aktuale që do të rrjedhnin nga regjistrimi, dhe problemet të cilat ekzistojnë në interpretimin e statistikave vitale që dihet se janë seriozisht të nën-raportuara, vendim-marrësit çdo herë e më shumë u vetëdijësuan se ekzistonte nevoja për një anketë të dytë demografike dhe të shëndetit riprodhues. Është menduar se anketa do të shërbej për disa qëllime të rëndësishme:

- Të ofrojë informata të besueshme, relevante dhe aktuale për përpjekjet zhvillimore që janë në vazhdim e sipër në Kosovë;
- Të ofrojë bazat për krahasimin me rezultatet e anketës së vitit 1999, pra të shërbej si shënues i ndryshimeve të cilat janë paraqitur gjatë viteve të fundit;
- Të ofrojë mbështetje për avokimin e realizimit të regjistrimit të plotë të popullsisë dhe fuqizimin e sistemit vital të regjistrimit;
- Të ofrojë mekanizmin për fuqizimin e kapacitetit teknik të Entit të Statistikës së Kosovës (ESK) dhe pjesëmarrësve tjerë në planifikimin e anketës demografike dhe shëndetësore, punën në terren, analiza dhe përdorimin e të dhënave.

1.3 Disenjimi i Anketës

1.3.1 Mostra

Korniza e mostrimit përbëhet prej një liste prej 3 200 Zonave të Anketimit (ZA). Mostra për ADSH është marrë si mostër e stratifikuar π ps me probabilitet të selektimit proporcional me numrin e ekonomive familjare në secilën ZA në kornizë. ZA-të janë stratifikuar sipas regjionit (7), përkatësisë etnike (jo-serb/serb) dhe urbane/rurale. Ekonomitë familjare në 400 ZA-të e zgjedhura janë përfshirë në listë dhe një mostër e fazës së dytë prej 8 ekonomive familjare është marrë prej listës nga secila ZA me probabilitet të barabartë të selektimit. Kështu madhësia e mostrës së planifikuar ishte 3.200 ekonomi familjare.

Ponderimi, w_i , ishte kalkuluar si $w_i = (1/\pi_i) \times (N_i/8)$, ku π_i është probabiliteti se ZA-ja e i -të është përfshirë në mostër dhe N_i është numri i ekonomive familjare në ZA-në e i -të.

¹ In its report *Public Expenditure Priorities Report for Kosovo*

Për shkak të mospërgjegjjes në tetë zona të anketimit ishin intervistuar vetëm nga 7 ekonomi familjare. Në këto 8 ZA ponderimi është përshtatur për të kompensuar mospërgjegjjet. Rrjedhimisht numri i përgjithshëm i ekonomive familjare të anketuara ishte 3.192, me përfshirjen e 196 vendbanimeve, 283 zonave statistikore dhe 400 zonave të anketimit. Niveli i mospërgjegjjes është shumë i vogël dhe nuk do të dëmtoj tepër cilësinë e anketës.

Mungesa e regjistrimit ka krijuar probleme në krijimin e një kornize të azhurnuar të mostrimit. Është ngritur pyetja se a është i mundshëm apo jo sigurimi i vlerësimeve të besueshme prej anketës së bazuar në kornizën e ZA-ve me një numër të pasaktë të ekonomive familjare. Kërkesë esenciale është që korniza të mbulojë tërë territorin e Kosovës. Mungesa e njohurive rreth numrit të vërtetë të ekonomive familjare brenda secilës ZA në kornizë nuk duhet të shkaktoj çfarëdo gabimi sistematik në vlerësime për sa kohë që lista e ZA-ve të zgjedhura në fazën e parë është e plotë dhe pa gabime të mëdha. Duke ditur mundësinë për gabime, kujdes i madh i është kushtuar zbatimit të përpiktë të procedurave të mostrimit dhe sigurimit se identifikimi në terren i ekonomive familjare të selektuara është kontrolluar në mënyrën e duhur, që do të rezultonte me gabime minimale mostruese dhe jo-mostruese të ndërlidhura.

Megjithatë, gjatë verifikimeve fillestare në terren është kuptuar se futja në listë e s'paku disa ZA-ve ishte jo e plotë. Për të korrigjuar problemin, është rishqyrtuar lista e ekonomive familjare. Vërej se nëse numri i ekonomive familjare të përfshira në listë është më i vogël se numri i vërtetë i ekonomive familjare atëherë ponderimi (faktori i rritjes) do të jetë shumë i vogël. Nëse numri i ekonomive familjare në kornizën e cili është përdorur si masë është pa gabime, atëherë mund të presimin një komponentë më të vogël të variacionit të vlerësimit të pikës prej mostrës së fazës së parë. Anasjelltas, kur numri të jetë jokorrekt do të rritet *variacioni*. Ne shpresojmë se numri i ekonomive familjare në kornizë dhe numri i vërtetë janë përafërsisht të barabartë. Edhe nëse nuk është kështu vlerësimet ende do të jenë të paanshme me kushtë që lista e ZA-ve të zgjedhura të jetë korrekte, por variacioni i vlerësimeve do të rritet.

Ponderimi jokorrekt kryesisht do të ndikoj në numrat absolut; mesataret dhe vlerësimet në përqindje ndikohen shumë më pak. Për shkak të problemeve të shoqëruara me mungesën e kornizës së regjistrimit të popullsisë, është e pamundshme të dihet shtrirja e vërtetë e gabimeve në ponderim. Për këtë arsye rezultatet në këtë raport janë paraqitur kryesisht si shpërndarje e përqindjeve.

1.3.2 Pyetësori

Ka pasur dobi reale nga mbajtja e pyetjeve kyçe të parashtruara në vitin 1999, pasi që kjo ofron bazat për krahasimin e matjeve të ndryshimeve të fundit. Si shtesë mbajtjes së shumicës së pyetjeve, struktura e përgjithshme e pyetësorit është gjithashtu e ngjashme me atë të raundit të parë, dhe përmban një faqe kontrolluese, një komponent të ekonomisë familjare dhe një komponentë individuale. Si në vitin 1999, pyetjet nga pjesa e përgjithshme e pyetësorit individual i janë shtruar të gjithë anëtarëve të ekonomisë familjare. Megjithatë disa ndryshime ishin të pashmangshme; pyetjet për fertilitetin dhe punësimin, për shembull, janë ndryshuar për t'u përshtatur me praktikën ndërkombëtare. Pyetjet për kontrceptim dhe fertilitet janë kufizuar tek gratë e moshës 15-49 vjeçe, me

shpresë se fokusimi i mprehtë tek gratë e moshë riprodhuese do të përmirësoj cilësinë e përgjigjeve. Për arsye të ngjashme, pyetjet janë kufizuar në historinë e lindjeve e jo në historitë e plota të shtatëzanive të përfshira në vitin 1999.

Pas diskutimeve shteruese me pjesëmarrësit, është përfshirë një numër i pyetjeve të reja, posaçërisht në sferën e shëndetit riprodhues, duke përfshirë njohuritë për AIDS-in (për të parë pyetësorin e plotë shiko aneksin).

1.3.3 Trajnimi dhe puna në terren

Punëtorët e terrenit janë trajnuar për dy ditë, 6-7 korrik 2003. Është përgatitur një doracak i detajuar trajnimi, që ka shërbyer edhe si libër referimi gjatë anketimit. Personeli i lartë në ESK e ka mbajtur trajnimin.

Puna në terren është realizuar gjatë tri javëve në korrik të vitit 2003. Gjithsej janë angazhuar 82 anketuesë. Janë vendosur disa nivele të mbikëqyrjes për të siguruar se janë realizuar intervista të cilësisë së lartë. Anketa ka angazhuar 14 mbikëqyrës, dhe menaxherët e kontrollit të cilësisë nga zyrat regjionale dhe nga selia e ESK-së.

1.3.4 Përpunimi i të dhënave

Verifikimi manual i formularëve është bërë në zyrat regjionale menjëherë pas përfundimit të punës në terren dhe gabimet më serioze ishin zgjidhur në terren. Formularët ishin dërguar në zyrën e ESK-së në Prishtinë ku është bërë kodimi i të dhënave. Njëmbëdhjetë zyrtarë për përfshirjen e të dhënave ishin trajnuar dhe ishin në gjendje të kryejnë përfshirjes së të dhënave. Personeli i ESK-së përgatiti specifikacionet e korigjimit dhe realizoi korigjimin nga fundi i nëntorit të vitit 2003.

Fillimisht, si edhe në vitin 1999, sistemi i përpunimit të të dhënave ishte disenjuar me përdorimin e MS ACCESS. Ky sistem nuk konsiderohej të ishte mjaftë fleksibil për të pastruar dosjet e të dhënave ose për të prodhuar tabela. Si rezultat të dhënat janë transferuar në dosjet e SPSS-së, më të përshtashme për kompletuar anketën.

Kapitulli 2: Popullsia, Banimi dhe Ekonomitë Familjare

Ky kapitull ofron një përmbledhje të karakteristikave demografike dhe të ekonomive familjare të popullsisë së ekonomive familjare, duke përfshirë moshën, gjininë, vendbanimin, strukturën e ekonomisë familjare dhe pajisjet e ekonomisë familjare. Informatat e grumbulluara mbi këto karakteristika janë të rëndësishme në kuptimin dhe interpretimin e rezultateve të anketës.

2.1 Popullsia sipas Moshës dhe Gjinisë

Përbërja e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë është rezultat i lindjeve, vdekjeve dhe migrimëve të kaluara. Prandaj ajo jap shumë informata për sjelljet e fundit demografike si dhe variabla të rëndësishme në studimin e vdekshmërisë, fertilitetit dhe shëndetit. Tabela 2.1 paraqet shpërndarjen e popullsisë së ekonomisë familjare në grupmosha pesëvjeçare, sipas vendbanimit urban-rural dhe gjinisë. Kjo informatë është përdorur për të ndërtuar piramidat e popullsisë të treguar në figurën 2.1.


<u>Tabela 2.1 Popullsia sipas moshës, gjinisë dhe vendbanimit</u>									
Shpërndarja në përqindje e popullsisë dhe numri i vështruar nga mostra e anketës në grupmosha pesëvjeçare, sipas gjinisë dhe vendbanimit, Kosovë 2003									
Moshë	Urban			Rural			Gjithsej		
	Mashkuj	Femra	Gjithsej	Mashkuj	Femra	Gjithsej	Mashkuj	Femra	Gjithsej
0-4	9.9	9.0	9.4	11.5	10.6	11.0	11.5	10.6	11.0
5-9	10.5	9.7	10.1	11.3	10.3	10.8	11.3	10.3	10.8
10-14	10.7	10.2	10.4	11.7	10.8	11.3	11.7	10.8	11.3
15-19	9.7	9.6	9.6	10.8	9.8	10.3	10.8	9.8	10.3
20-24	9.9	9.2	9.5	9.3	9.9	9.6	9.3	9.9	9.6
25-29	7.9	8.8	8.4	7.7	9.1	8.4	7.7	9.1	8.4
30-34	6.4	8.0	7.2	6.2	6.9	6.6	6.2	6.9	6.6
35-39	6.2	6.1	6.2	5.7	6.8	6.3	5.7	6.8	6.3
40-44	6.0	6.2	6.1	6.5	5.4	5.9	6.5	5.4	5.9
45-49	5.2	5.3	5.3	4.3	4.1	4.2	4.3	4.1	4.2
50-54	4.8	4.8	4.8	3.5	3.7	3.6	3.5	3.7	3.6
55-59	4.0	4.6	4.3	2.9	2.7	2.8	2.9	2.7	2.8
60-64	3.5	2.2	2.8	2.4	3.1	2.7	2.4	3.1	2.7
65-69	2.2	2.4	2.3	2.4	3.0	2.7	2.4	3.0	2.7
70-74	1.5	2.0	1.8	2.0	1.8	1.9	2.0	1.8	1.9
75-79	0.7	1.1	0.9	1.1	1.0	1.0	1.1	1.0	1.0
80-84	0.5	0.6	0.5	0.4	1.7	0.5	0.4	0.7	0.5
85+	0.2	0.3	0.3	0.4	0.3	0.3	0.4	0.3	0.3
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Popullsia e përgjithshme e ekonomive familjare në anketë ishte 18.603. Më shumë se gjysma (55 përqind) e popullsisë është në grupmoshën 15-59 vjeç; kjo grupmoshë


referohet si popullsi ekonomisht aktive. Proporcioni e popullsisë që bie në këtë grupmoshë është pak më i lartë në zonat urbane se sa në zonat rurale (57 dhe 55 përqind). Përafërsisht një e treta (32 përqind) e popullsisë janë fëmijë nën moshën 15 vjeç. Struktura e moshës në Kosovë është treguar në figurën 2.1.

Figura 2.1 Piramidat e Popullsisë

Kosovë RURAL - 2003



Kosovë URBAN - 2003



Proporcioni i madh i popullsisë nën 15 vjeç mund të jetë funksion i largimit të popullsisë të moshës së mesme të punës, duke pasur parasysh faktin se migrimi ka qenë mjaftë i theksuar në vitet e fundit. Kjo është mbështetur nga një numër i madh i personave, që nga kryetarët e ekonomive familjare, janë raportuar të jenë jashtë vendit në kohën e anketës. Përqindja e personave të moshës 60 vjeç e lartë nuk është i lartë sipas standardeve

Evropiane, por me rënjen e vdekshmërisë dhe fertilitetit është e gjasme se do të rritet gjatë disa dekadave të ardhshme.


Baza e piramidave paraqet fertilitetin e fundit; në një piramid tipike, baza zgjerohet pasi që numri i lindjeve rritet çdo vit. Gjerësia e zvogëluar e shiritave në bazën e strukturës ilustron rënien e fertilitetit në Kosovë. Kjo do të eleborohet në kapitullin 4. Karakteristikë tjetër që duhet të vërehet është ngushtimi i shiritave në moshat 30-39 vjeç, posaçërisht për meshkujt. Disa prej këtyre ngushtimeve mund të jenë rezultat i vdekshmërisë së shtuar gjatë gjendjes së luftës, por arsye kryesore me gjasë është migrimi selektiv sipas moshës dhe gjinisë që ka ndodhur në të kaluarën. Për shkak të problemeve metodologjike të matjes së migrimit ndërkombëtar, kjo temë nuk është përfshirë në detaje në këtë anketë. Megjithatë, në kapitullin 8 janë dhënë disa tregues për personat që në kohën e anketës kanë qenë jashtë vendit.

Një numër relativisht i vogël i grave që tani kanë arritur moshën 30-40 vjeç do të lind më pak fëmijë se popullsia me shpërndarje të zakonshme. Numri i grave në vitet e tyre të hershme riprodhuese megjithatë është ende mjaftë i madh dhe rrjedhimisht do të kontribuoj në rritjen e numrit të lindjeve, pavarësisht prej faktit se gratë po kanë më pak fëmijë se sa më parë. Në aspektin afatgjatë, pasojat e fertilitetit të zvogëluar gjatë disa viteve të fundit, si kthim do të siguroj fillimin e rënies së numrit aktual të lindjeve.

Figura 2.2 paraqet proporcionet mes gjinive të marra prej rezultateve të anketës; proporcionet mes gjinive referohen në numrin e meshkujve në secilën grupmoshë për çdo njëqind femra. Ia vlen t'i komentohet niveli dhe sjellja e proporcioneve mes gjinive në Kosovë. Në shumicën e shoqërive, propocioni mes gjinive në lindje dallon me rreth 103 dhe 105 meshkuj të lindur për çdo 100 femra të lindura. Gjatë pesë viteve pas lindjes, kur vdekshmëria është relativisht e lartë, ka vdekshmëri më të madhe të meshkujve. Mirëpo në Kosovë propocioni mes gjinive në moshat 0-19 vjeç janë vazhdimisht shumë të larta, që shtrihen pre 107 gjer në 109. Në mënyrë bindëse mund të argumentohet se duke pasur parasysh se çka dihet për preferencat për djemë në Kosovë foshnjat femra janë nën-raportuar. Megjithatë, mënyra në të cilën është përgatitur anketa e popullsisë në ekonomitë familjare dhe mënyra në të cilën historitë e lindjeve të grave në moshat riprodhuese janë realizuar, mundësia për anshmëri të madhe në selektiv praktikisht janë përjashtuar. Gjersa ky fenomen në statistika është vështruar prej burimeve tjera, veçanërisht prej statistikave vitale, paraqitja e saj në anketë duhet të theksoj nevojën për gjurmime të mëtejshme.

Dallimet në mes të gjinive të cilat janë rezultat të emigrimit selektiv gjinor tanimë janë të njohura. Figura 2.2 tregon qartë se në Kosovë ka më shumë gra se burra të moshave 20-40 vjeç. Megjithatë në kapitullin 8 do të shohim se numri i meshkujve dhe femrave anëtarë të ekonomive familjare që mungojnë në këtë grupmoshë, të raportuar nga kryetarët e ekonomive familjare, nuk është i mjaftueshëm për të shpjeguar proporcionet aktuale mes gjinive në këto grupmosha. Figura 2.2, gjithashtu, paraqet një strukturë të çuditshme të proporcionit mes gjinive pas moshës 40 vjeç. Gjurmime të mëtejshme kërkohen për të zbuluar shkaqet për këtë strukturë; një mundësi e fuqishme mund të jetë thjeshtë për shkak të raportimit të gabuar të moshës.

**Figura 2.2. Propocioni mes gjinive
Kosovë,2003**



2.2 Struktura e ekonomive familjare

Në anketë është e rëndësishme të sigurohet se personat të cilët janë me banim të përhershëm në Kosovë të caktohen vetëm në një ekonomi familjare². Duke pasur parasysh kujdesin të cilin personat në Kosovë, në kohën e anketës, ndienin ndaj anëtarëve të familjeve të tyre ishte shumë e rëndësishme që në kohën e anketës definicioni statistikor i statusit të banorit të ishte shumë i qartë.

Ekonomitë Familjare kosovare tradicionale janë të mëdha. Tabela 2.2 paraqet shpërndarjen e ekonomive familjare bazuar në madhësinë e ekonomisë familjare sipas vendbanimit urban dhe rural.

<u>Tabela 2.2 Përbërja e Ekonomisë Familjare</u>			
Shpërndarja në përqindje e ekonomive familjare bazuar në madhësinë e ekonomisë familjare sipas vendbanimit urban-rural.			
Karakteristika	Urban	Rural	Gjithsej
Numri i anëtarëve të zakonshëm			
1	2.7	1.5	1.9
2	7.1	4.3	5.2
3	9.4	6.2	7.3
4	17.7	10.6	12.9
5	20.8	14.2	16.4

² Në anketë ekonomia familjare ishte definuar si “bashkësi e personave të cilët jetojnë s’bashku dhe ushqehen s’bashku dhe i përdorin bashkë të ardhurat e tyre. Një ekonomi familjare përbëhet nga një ose më shumë familje dhe mund të kenë anëtarë të cilët nuk i përkasin asnjërës familje në ekonominë familjare. Personi i cili jeton vetëm duhet të konsiderohet të jetë ekonomi familjare me një person. Gjithashtu mund të gjinden ekonomi familjare ku persona që nuk janë të afërt jetojnë s’bashku”.

Tabela 2.2 Përbërja e Ekonomisë Familjare			
Shpërndarja në përqindje e ekonomive familjare bazuar në madhësinë e ekonomisë familjare sipas vendbanimit urban-rural.			
6	15.4	15.8	15.7
7 ose më tepër	26.8	47.3	40.6
Gjithsej	100	100	100
Numri i familjeve në ekonominë familjare			
1	73.3	64.6	69.6
2	20.9	25.7	23.0
3	4.6	7.0	5.6
4 ose më tepër	1.2	2.8	1.8
Gjithsej	100	100	100

Në Kosovë, ekonomitë familjare shpesh përbëhen nga një njësi e zgjeruar familjare që përfshinë disa gjenerata. Si rezultat ka shumë pak familje me një person. Më tepër se 59 përqind e ekonomive familjare kanë s'paku 6 anëtarë. Ekonomitë familjare rurale janë më të mëdha se ato urbane. 47 përqind e ekonomive familjare urbane përmbajnë 7 ose më tepër anëtarë krahasuar me 27 përqind të ekonomive familjare rurale. Madhësia mesatare e ekonomisë familjare rurale vlerësohet të jetë 6.4 persona.

Jo vetëm që familjet janë të mëdha, por gjithashtu ekonomitë familjare shpesh përbëhen nga më shumë se një familje e vetme. Siç mund të shihet në tabelën 2.2, në përgjithësi 70 përqind e ekonomive familjare përmbajnë një familje të vetme. Pjesa tjetër prej 30 përqind e ekonomive familjare përbëhet prej 2 ose më tepër familjeve; 23 përqind me dy dhe pak mbi 7 përqind me tri ose më tepër familje. Ekonomitë familjare rurale mesatarisht përmbajnë më tepër familje se ekonomitë familjare urbane. Për shembull, në zonat urbane më pak se 5 përqind e ekonomive familjare përbëhen prej 3 ose më tepër familjeve krahasuar me 7 përqind në zonat rurale.

2.3 Karakteristikat e kryetarit të ekonomisë familjare

Kryetar i ekonomisë familjare është personi i cili konsiderohet të jetë 'kryetar' nga anëtarët tjerë të ekonomisë familjare. Personi i zgjedhur shpesh, por jo çdo herë, ishte anëtari i cili fitonte pagën më të madhe. Tabela 2.3 paraqet shpërndarjen e ekonomive familjare sipas gjinisë së kryetarit të ekonomisë familjare për vendbanimet urbane dhe rurale. Shumica e kryetarëve të ekonomive familjare janë meshkuj, që përbëjnë rreth 93 përqind të numrit të përgjithshëm.

Siç tregon tabela 2.3, 88 përqind e kryetarëve të ekonomive familjare aktualisht janë të martuar. Shpërndarjet sipas gjinisë theksojnë dallimet e vërejtura. Më tepër se 93 përqind e kryetarëve meshkuj të ekonomive familjare janë të martuar. Për femrat, për dallim, më pak se 28 përqind janë të martuara. Përqindje më e madhe e kryetarëve femra janë të pamartuara se që është rasti me kryetarët meshkuj. Por diferenca më e theksuar në shpërndarje është për personat e ve. Më shumë se 65 përqind e femrave kryetare të

ekonomive familjare janë të veja, krahasuar me më pak se 4 përqind të kryetarëve meshkuj që janë vejana. Kryesisht kjo është rezultat e mortalitetit selektiv gjinor.

Për meshkujt kryetar të ekonomive familjare, dallimet në mes të vendbanimeve urbane dhe rurale janë të vogla. Mirëpo, për femrat dallimet janë të mëdha. Përqindja e femrave të martuara kryetare të ekonomisë familjare në zonat urbane është veçanërisht e ulët, më pak se 13 përqind. Por përqindjet për beqare, të shkurorzuara dhe të veja të gjitha janë më të larta se në zonat rurale. Përqindja e kryetareve femra të veja është veçanërisht e lartë në zonat urbane me 77 përqind. Këto ekonomi familjare urbane me kryetare të ve me gjasë janë më të rrezikuara, gjë që tregon nevojën për kërkime të mëtejshme.

Tabela 2.3 Kryetarët e ekonomive familjare sipas gjendjes martesore, vendbanimit dhe gjinisë
Shpërndarja në përqindje e ekonomive familjare bazuar gjendjen martesore të kryetarit të ekonomisë familjare sipas gjinisë dhe vendbanimit urban-rural.

Karakteristika	Urban		Rural		Gjithsej		Gjithsej
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
Gjendja martesore							
Beqar/e	3.7	6.9	2.1	4.8	2.6	5.7	2.8
I/e martuar	92.5	12.7	93.6	38.7	93.3	27.6	88.2
I/e shkurorëzuar	0.2	3.4	0.4	0.2	0.3	1.6	0.4
I/e ve	3.6	77.0	3.9	56.3	3.8	65.1	8.6
Gjithsej	100	100	100	100	100	100	100

2.4 Karakteristikat e banimit

Anketa ka shtruar pyetje sa i përket tipit aktual të ndërtesës në të cilin të anketuarit ishin duke jetuar dhe statusin e zotërimit të asaj ndërtese. Këto informata janë paraqitur në tabelën 2.4. Shumica e të anketuarve nga mostra (86 përqind) jetonin në shtëpitë e përshkruara si shtëpi të vetme që karakterizoheshin me një hyrje të vetme. Megjithatë ekzistonin dallimet në mes të zonave urbane dhe rurale; mbi 28 përqind e njësive urbane të banimit ishin pallate ose apartamente, krahasuar me 6 përqind të njësive rurale. 98 përqind e ekonomive familjare jetojnë në shtëpi ose apartamente që definoohen si banesa konvencionale. Në zonat urbane, më tepër se 1 përqind e njësive të banimit janë përshkruar si banesa kolektive. Nuk ka banesa kolektive të përfshira në mostrën rurale.

Shumica e shtëpive dhe apartamenteve janë pronë e banorit. Në përgjithësi 95 përqind e ekonomive familjare pohojnë se janë pronar të shtëpisë ose apartamentit në të cilin banojnë; 14 përqind thonë se janë qiraxhi dhe 3.5 thonë se jetojnë në shtëpi ose apartament nën kushte tjera. Një numër më i madh i banorëve rural pohojnë se janë pronar të shtëpive ose apartamenteve të tyre krahasuar me banorët urban. (98 përqind me 90 përqind).

Tabela 2.4 Tipi i banimit dhe gjendja e zotërimit sipas vendbanimit			
Shpërndarja në përqindje e tipeve të banimit dhe gjendja e zotërimit sipas gjinisë dhe banimit urban-rural.			
Karakteristika	Urban	Rural	Gjithsej
Tipi indërtesës			
Njësi e vetme banimi	71.6	93.7	86.3
Një ose më tepër njësi banimi	28.4	6.3	13.7
Gjithsej	100	100	100
Tipi i banesës së banuar			
Shtëpi ose apartament	97.9	98.3	98.2
Jo konvencional ³	0.9	1.7	1.4
Kolektiv ⁴	1.2	0	.4
Gjithsej	100	100	100
Statusi i zotërimit			
Pronar	89.6	97.7	95.1
Qiraxhi	3.6	0.4	1.4
Tjetër	6.8	1.9	3.5
Gjithsej	100	100	100

Të anketuarit janë pyetur të japin informata rreth kushteve të ekonomive familjare të tyre. Një listë i është lexuar secilit të anketuar dhe ata janë pyetur nëse banesa e banuar përmban pajisjet specifike. Tabela 2.5 paraqet karakteristikat kryesore të banimit sipas vendbanimit urban-rural.

Pothuajse të gjitha ekonomitë familjare kanë rrymë (98 përqind). Një prej brengava më të rëndësishme të shëndetit publik është i qasjes në ujë të pijshëm i ekonomive familjare. Anketa ka pyetur secilën ekonomi familjare rreth burimit kryesor të ujit të pijshëm. Për Kosovë, 52 përqind e ekonomive familjare kanë qasje në ujin nga ujësjellësi, që konsiderohet i sigurt për pije. Megjithatë veçori më e theksuar është diferenca e madhe që ekziston në mes zonave urbane dhe rurale. Në zonat urbane, më tepër se 92 përqind e ekonomive familjare kanë qasje në ujin nga ujësjellësi krahasuar me 33 përqind të ekonomive familjare rurale. Më tepër se gjysma e ekonomive familjare rurale varen nga pusët për ujë të pijës. 20 përqind e ekonomive familjare rurale përdorin ujin prej puseve të mbyllura ose shpimeve, dhe është alarmuese se pak më pak se një e katërta e ekonomive familjare rurale burim të ujit i kanë pusët e hapura gjë që mund të mbart rreziq të rëndësishme shëndetësore.

Për të gjitha pajisjet tjera, ekonomitë familjare urbane kanë përparësi të madhe krahasuar me ekonomitë familjare rurale. Shumica e ekonomive familjare urbane pohojnë të kenë

³ Shembuj të banesave të banuara jo-konvencionale janë dyqanet ose kasollat

⁴ Shembuj të banesave të banuara kolektive janë konviktet e punëtorëve ose kazemat

tualet të brendshëm, banjo/dush dhe kuzhinë të brendshme. Mbi 20 përqind e ekonomive familjare urbane kanë nxemje qëndrore; në ekonomitë familjare rurale shifra koresponduese është 2 përqind.

Table 2.5 Pajisjet e ekonomisë familjare sipas vendbanimit			
Shpërndarja në përqindje e ekonomive familjare bazuar në pajisjet e ekonomisë familjare sipas vendbanimit urban-rural.			
Karakteristika	Urban	Rural	Gjithsej
Rryma elektrike	99.3	96.8	97.6
Burimi i ujit të pijshëm			
Uji nga ujësjellësi brenda banesës	92.2	33.2	52.3
Uji nga ujësjellësi jashtë banesës	1.6	5.5	4.2
Çezme publike	0.4	2.2	1.6
Ujë prej pusit të hapur	2.6	27.4	19.3
Ujë prej pusit të mbuluar ose shpimit	3.0	28.0	19.9
Uji sipërfaqësor prej burimit/lumit/pellgut		3.3	2.2
Cisterna/kamioni	0.1	0.2	0.2
Nxemja qëndrore	20.8	2.2	8.2
Tualeti i brendshëm	94.3	70.9	78.5
Banjoja ose dushi i brendshëm	89.0	51.4	63.3

2.5 Treguesit e varfërisë

Disponueshmëria e mallrave të qëndrueshme mund të merret si tregues i afërt i statusit socio-ekonomik. Tabela 2.6 tregon shpërndarjen e mallrave të qëndrueshme dhe mjetet e transportit në ekonomitë familjare. Shkallët e larta të posedimit të televizorëve dhe radiove sigurojnë se shumica e ekonomive familjare kanë qasje në s'paku njërin nga këto forma të mediave. Pothuajse gjysma e ekonomive familjare pohojnë se kanë telefona mobil. Telefonat fiks janë më pak të përhapur, i kanë vetëm 27 përqind e ekonomive familjare. Qasja në kompjuter pa dyshim është në rritje, ndonëse ngopja ende është e ulët, 9 përqind pohojnë të kenë kompjuter.

Pronësia e mjeteve transportuese nga ekonomitë familjare është mjaft e balancuar në mes të zonave urbane dhe rurale, rreth gjysma e numrit të ekonomive familjare pohojnë se kanë në pronësi një automobil, furgon, ose kamion; përqindje të ngjashme të ekonomive familjare urbane dhe rurale pohojnë të kenë motoçikleta (megjithëse shkalla është shumë e ulët). Për arsye të qarta, pronësia e traktorëve është shumë më e lartë në zonat rurale, ku më shumë se 30 përqind e ekonomive familjare pohojnë të posedojnë një të tillë. Posedimi i telefonit dhe kompjuterëve në zonat rurale ende është goxha luks.

Tabela 2.6 Posedimi i asetëve nga ekonomitë familjare sipas vendbanimit Shpërndarja në përqindje e ekonomive familjare që posedojnë artikuj të qëndrueshëm të konsumit të gjerë sipas vendbanimit urban-rural.			
Artikull i qëndrueshëm i konsumit të gjerë	Urban	Rural	Gjithsej
Televizori	96.8	90.1	92.3
Radio	84.8	77.0	79.5
Frigoriferi	90.4	76.6	81.1
Telefoni	60.7	10.5	26.8
Vetura/furgoni/kamioni	53.1	49.5	50.7
Telefoni mobil	56.0	45.1	48.7
Kompjuteri	18.0	5.1	9.3
Traktori	3.8	30.2	21.7
Motoçikleta	3.4	3.5	3.5

Pyetja mbi të ardhurat e ekonomisë familjare është shtruar në anketë me dijen se në përgjigje do të raportohen nivele më të ulëta të të ardhurave se ato të vërteta. Megjithatë, pyetja është përfshirë në bazën se shpërndarja e ekonomive familjare sipas të ardhurave ofron mjete shumë të dobishme për të identifikuar më të varëfërit dhe me këtë ekonomitë familjare dhe anëtarët e ekonomive familjare më të rrezikuara në Kosovë. Madje kur të merret parasysh një masë e nën-raportimit, e habitshme është se numër i madh i ekonomive familjare kanë raportuar të ardhura më të vogla se 200 euro për muaj, siç është treguar në tabelën 2.7. Tabela gjithashtu tregon se të ardhurat urbane janë më të larta se ato rurale, ndonëse madje edhe në zonat urbane më tepër se gjysma e ekonomive familjare pohojnë se fitojnë më pak se 200 euro në muaj.

Tabela 2.7 Të ardhurat e ekonomisë familjare sipas vendbanimit Shpërndarja në përqindje e ekonomive familjare sipas të ardhurave të përgjithshme të ekonomisë familjare			
Euro	Urban	Rural	Gjithsej
0-100	24.0	31.8	29.3
101-200	28.4	33.2	31.7
201-300	25.3	17.1	19.8
301-400	12.8	10.9	11.5
401-800	7.6	5.6	6.2
801 dhe mbi	1.9	1.4	1.5
Gjithsej	100	100	100

Kapitulli 3: Karakteristikat Personale të Popullsisë së Anketuar

Qëllimi i këtij kapitulli është ofrimi i profilit demografik dhe socio-ekonomik të popullsisë së anketuar. Informatat mbi karakteristikat themelore të grave dhe burrave të intervistuar në anketën janë esenciale për interpretimin e rezultateve të prezentuara më vonë në raport dhe mund të ofrojnë një tregues të përafërt të nivelit përfaqësues të anketës. Ky kapitull do të ofroj informata të detajuara për martesat, arsimin dhe punësimin në Kosovë.

3.1 Karakteristikat biografike të të anketuarëve

Tabela 3.1 paraqet shpërndarjen në përqindje të grave dhe burrave të intervistuar të moshës 15-59 vjeç sipas karakteristikave personale duke përfshirë grupmoshën, gjendjen martesore, vendbanimin, përkatësinë etnike dhe nivelin e arsimit.

Përqindja e grave në grupmoshat pesëvjeçare bie vazhdueshëm pas moshës 25 vjeçare. Përqindja e grave të moshës 15-19 vjeçe (16.3 përqind) është më tepër se trefishi i përqindjes së grave të moshës 55-59 vjeçe. Një strukturë e ngjashme e rënjes së numrave me rritjen e moshës është parë edhe për burra.

Rreth 59 përqind e burrave dhe grave janë të martuar. Shkurorëzimi në Kosovë nuk është i zakonshëm me më pak se gjysëm përqind të burrave dhe grave që kanë raportuar të jenë të shkurorëzuar. 34 përqind e grave dhe 43 përqind e burrave kurrë nuk kanë qenë të martuar.

Shumica dërrmuese e meshkujve dhe femrave të anketuara raportojnë se janë me përkatësi etnike shqiptare. Rreth 4 përqind e burrave dhe grave kanë raportuar veten si serb, megjithatë numrat e vështuar në mostër paraqesin përqindje më të larta se sa të dhënat e ponderuara. Rreth 3 përqind e burrave dhe grave kanë raportuar se janë të një përkatësie tjetër etnike. Kjo kategori mes tjerash përfshinë Malazezë, Kroatë, Turqë, Boshnjakë, Romë dhe Goranë; megjithatë numrat në secilën prej këtyre kategorive ishin shumë të vegjël për t'i analizuar individualisht.

Të gjithë pjesëmarrësit në anketë, përveç 61 burrave dhe 257 grave, kanë ndjekur shkollimin gjer në një nivel të caktuar. Duket se burrat kanë nivel më të lartë të arsimit se gratë. 57 përqind të burrave kanë ndjekur ndonjë form të shkollimit të mesëm krahasuar me 26 përqind të grave.

Tabela 3.1 Karakteristikat personale të anketuarëve

Shpërndarja në përqindje e numrave të vështruar në mostrën e burrave dhe grave të moshës 15-59 vjeç sipas moshës, vendbanimit, gjendjes martesore, përkatësisë etnike dhe arsimit.

Karakteristikat personale	Numri i grave		Numri i burrave		Gjithsej	
	Përqind. e ponderuar	Numri vështruar	Përqind.e ponderuar	Numri i vështruar	Përqind.e ponderuar	Numri i vështruar
Mosha						
15-19	16.3	895	18.1	944	17.2	1839
20-24	16.3	884	16.3	861	16.3	1745
25-29	15.2	806	13.5	706	14.3	1512
30-34	12.1	711	10.8	617	11.5	1328
35-39	11.1	602	10.1	556	10.6	1158
40-44	9.4	563	11.0	585	10.2	1148
45-49	7.4	425	7.9	466	7.7	891
50-54	6.7	450	6.7	401	6.7	851
55-59	5.4	379	5.6	343	5.5	722
Total	100	5715	100	5479	100	11194
Gjendja martesore						
Beqar(e)	33.9	1868	42.6	2241	38.2	4109
I/e martuar	62.1	3590	56.6	3182	59.4	6772
I/e shkurorezuar	0.5	23	0.2	12	0.4	35
I/e ve	3.5	229	0.5	39	2.0	268
Gjithsej	100	5710	100	5474	100	11184
Përkatësia etnike						
Shqiptar	92.2	4938	92.2	4645	92.7	9583
Serb	4.3	576	5.3	689	4.3	1265
Tjerë	3.6	201	2.5	145	3.0	346
Gjithsej	100	5715	100	5479	100	11194
Arsimi						
Pa shkollë	5.4	257	1.2	61	3.3	318
Shkollimi Fillor ⁵	66.0	3225	36.4	1726	51.5	4951
Shkollimi i mesëm ose i lartë ⁶	26.3	2065	57.0	3316	41.3	5381
Universiteti ose më lartë	2.3	165	5.4	369	3.8	534
Gjithsej	100	5712	100	5472	100	11184

⁵ Ky nivel përfshinë tri kategori të përgjigjes të ofruara në pyetësor: më pak se fillore 1-4, më pak se fillore 5-7, dhe fillore e mbaruar

⁶ Ky nivel përfshin katër kategori të përgjigjes në pyetësor: e mesme 1-3, e mesme 4 dhe më tepër, gjimnaz dhe shkollë e lartë

3.2 Gjendja Martesore


Si në vitin 1999, bazuar në moshën e raportuar të martesës, anketa ka treguar se moshja mesatare e martesës së parë është rreth 25 dhe 21 vjeç për meshkuj dhe femra respektivisht. Megjithatë, rezultate pak më të ndryshme janë siguruar duke përdorur një metod më komplekse të kalkulimit të moshës në martesën e parë⁷ që vlerëson numrin e viteve për secilin burrë ose grua do të kalojë i/e pamartuar gjër në moshën 50 vjeç, nëse ai ose ajo do përjetonin shkallët aktuale të martesës. Siç tregon tabela 3.2, kjo metodë, duke injoruar shpërndarjen aktuale të moshës së popullsisë, ofron moshja më të larta të hyrjes në martesë si për burrat ashtu edhe për gratë, 24 dhe 27 vjeç përkatësisht. Moshja mesatare relativisht e lartë e beqarisë në kohën e hyrjes në martesë sugjeron se disa vonesa paraqiten në martesën e parë dhe konfirmon vazhdimin e dallimeve në moshën e martesës të burrave dhe grave. Të dhënat e anketës zbulojnë një rritje të vogël në numrin e personave që mbesin të beqarë për meshkuj dhe femra, një trend që është konsistent me modelet në vendet tjera Evropiane.

Vendbanimi	Moshja me rastin e martesës	
	Burra	Gra
Urban	26.5	24.8
Rural	27.2	24.0
Gjithsej	27.0	24.2


Mesatarisht, moshat në martesën e parë për zonat urbane dhe rurale janë mjaftë të ngjashme. Megjithatë, diferenca më e mëdha që paraqitet në zonat rurale në moshë me rastin e martesës për meshkuj dhe femra është interesante, dhe ndoshta paqyron mungesën relative të mundësive të arsimit dhe punësimit në dispozicion të grave në zonat rurale.

Figura 3.1 tregon shpërndarjen e personave të martuar sipas gjinisë dhe moshës; është e qartë se gratë martohen më herët. Në moshat më të reja, diagrami tregon vlera më të larta për gra se për burra. Rënia relative për gra në moshat më të vjetra në të vërtetë fare nuk është rezultat i martesës, por rezulton prej vdekjes së shtuar me ngritjesn e moshës. Pjesërisht si rezultat e këtij efekti të vdekshmërisë, për burra dhe për gra, shkallët e martesës rriten gjërë në moshën 35 vjeç, në të cilën moshë rënia fillon për gra, gjersa shkalla vazhdon të rritet për burra.

⁷ Bazuar në metodologjinë e cila njihet si moshja mesatare e beqarisë me rastin e martesës që në mënyrë efektive standardizon shpërndarjen e popullsisë, kontrollin për popullsinë e re të Kosovës dhe mundëson të bëhen më lehtë krahasime në kohë dhe në mes të vendeve.



Në moshat më të reja siç është treguar në figurën 3.2, shpërndarja e personave beqar është pasqyrë-imazh i shpërndarjes së martesës, duke treguar në këtë rast se femrat kanë më pak gjasa të mbesin beqare krahasuar me homologët e tyre meshkuj. Përparësia e këtij prezantimi është se përmban pak ndikime të vdekshmërisë dhe rrjedhimisht demonstroi qartë se aktualisht sa është universale martesja në Kosovë. Për burra dhe gra, nivelet e atyre që kurrë nuk janë martuar janë të neglizhueshme përtej moshës 50 vjeç.



3.3 Niveli arsimor i të anketuarve

Tabela 3.2 dhe 3.3 tregojnë nivelet arsimore të të anketuarve femra dhe meshkuj sipas karakteristikave personale të zgjedhura dhe numrit mesatar të viteve të shkollimit. Gratë urbane kanë arritur nivel më të lartë të arsimit se sa gratë rurale: numër dy herë e gjysëm më i madh i grave urbane kanë ndjekur shkollimin e mesëm krahasuar me homologet e tyre rurale. Femrat në zonat urbane kanë përparësi më të madhe se një vit të arsimit krahasuar me gratë në zonat rurale. Shenjë premtuese është se po duket se nivelet e arsimit janë në rritje me moshën dhe gjeneratën. Duke e vështruar grupmoshën më të vjetër, mund të shihet se rreth para dyzetë viteve vetëm njëzetë përqind e grave ishin të shkolluara përtej nivelit fillor. Megjithatë, duket se ka pasur përmirësim të qëndrueshëm në numrin e grave të cilat kanë ndjekur shkollimin përtej shkollimit fillor, dhe tridhjetë e tetë përqind e grave të moshës 20-24 vjeç kanë raportuar se kanë ndjekur shkollën e mesme.

Tabela 3.3 Arritjet në shkollim sipas karakteristikave personale: gratë								
Shpërndarja në përqindje e grave sipas nivelit më të lartë të shkollimit të ndjekur, dhe numri mesatar i viteve të shkollimit sipas moshës, vendbanimit dhe përkatësisë etnike, Kosovë 2003								
Karakteristikat personale	Niveli më i lartë i shkollimit të ndjekur						Mesatarja e viteve të shkollimit	
	Të pashkolluar	Fillor	Mesëm	Universitar	Gjithsëj	Numri i grave		
Mosha								
20-24	3.3	55.7	37.7	3.3	100	884	9.7	
25-29	0.8	72.0	24.9	2.3	100	806	9.0	
30-34	5.7	62.7	28.0	3.6	100	711	9.2	
35-39	6.1	65.7	24.9	3.3	100	602	9.0	
40-44	9.4	57.8	28.8	4.0	100	563	9.1	
45-49	8.6	69.7	20.0	1.7	100	425	8.1	
Vendbanimi								
Urban	12.9	52.7	31.1	3.3	100	5285	8.7	
Rural	15.5	71.2	12.4	0.9	100	4023	7.3	
Përkatësia etnike								
Shqiptar	14.5	67.0	16.9	1.6	100	8065	7.7	
Serb	13.7	43.4	40.7	2.2	100	930	9.1	
Tjerë	21.1	65.0	13.3	0.6	100	267	7.4	

Megjithëse dallimet në mes të burrave që jetojnë në zonat urbane dhe burave që jetojnë në zonat rurale janë më pak të theksuara se sa për gra, ekzistojnë struktura të ngjashme të arsimit të arritur dhe mesatarisht burrat me banim urban vazhdojnë shkollimin për një vit më gjatë se sa homologët e tyre në zonat rurale. Gjatë njëzetë viteve të fundit, duket se

është ndalur progresi në kryerjen e shkollimit, që reflektohet me përqindje stabile ose në rënje të kryerjes së shkollimit të mesëm.

Tabela 3.4 Arritjet në shkollim sipas informatave karakteristike: burrat								
Shpërndarja në përqindje e burrave sipas nivelit më të lartë të shkollimit të ndjekur, dhe numri mesatar i viteve të shkollimit sipas moshës, vendbanimit dhe përkatësisë etnike, Kosovë 2003								
Informatat karakteristike	Niveli më i lartë i shkollimit të ndjekur						Numri i burrave	Mesatarja e viteve të shkollimit
	Të pashkolluar	Fillor	Mesëm	Universitar	Gjithsej			
Mosha								
20-24	0.2	30.9	66.8	2.1	100	861	10.9	
25-29	1.3	29.1	65.5	4.1	100	706	11.1	
30-34	1.0	29.0	64.6	5.4	100	617	11.1	
35-39	1.2	23.2	68.6	7.0	100	556	11.5	
40-44	2.8	19.3	68.0	9.9	100	585	12.0	
45-49	0.3	32.0	57.1	10.6	100	466	11.2	
Vendbanimi								
Urban	6.3	42.2	44.5	7.0	100	5210	9.8	
Rural	7.7	53.0	36.7	2.6	100	4085	8.9	
Përkatësia etnike								
Shqiptar	7.5	50.4	38.4	3.7	100	8007	9.1	
Serb	3.5	34.7	56.1	5.7	100	1035	10.3	
Tjerë	8.0	63.4	25.3	3.3	100	253	8.2	

3.3.1 Arsimi aktual

Ndjekja aktuale e shkollimit sipas moshës dhe gjinisë ofron informata fundamentale rreth efikasitetit të politikave aktuale të arsimit. Siç tregon tabela 3.5 shkallët e pjesëmarrjes në shkollim janë të larta, posaçërisht për moshat 10-14 vjeçe, ku ata arrijnë 98 përqind të popullsisë. Shifrat më të ulëta në moshat 5-9 vjeç mund të shpjegohen me fillimin në moshë më të vonë të disa nxënësve. Shkalla e pjesëmarrjes në shkollim në moshat 15-19 vjeç bie në 63 përqind krahasuar me ndjekjen që është afër universalës në moshat 10-14 vjeç.

Tabela 3.5 Personat që aktualisht ndjekin shkollimin ose studiojnë sipas grupmoshës dhe gjinisë			
Grupmosha	Mashkuj	Femra	Gjithsej
5-9	69.4	62.7	66.2
10-14	98.9	96.5	97.7
15-19	70.7	54.0	62.7

20-24	15.8	13.5	14.6
25-29	4.4	2.4	3.3

Dallimet mes gjinive ekzistojnë në të gjitha moshat, ku djemtë kanë gjasa më të mëdha se femrat për të ndjekur shkollimin ose studimet. Folur në përgjithësi, diferenca mes gjinive rritet me avansimin e shkollimit. Në moshat 5-14 vjeç, djemtë gëzojnë përparësi ndaj vajzave, por diferencat nuk janë të mëdha. Në moshat 15-19 vjeç, për dallim, djemtë gëzojnë një avantazh prej 17 pikëve në përqindje krahasuar me vajzat. Madje edhe në nivelet më të larta të arsimit të shprehur me grupmoshën 25-29 vjeç, ndonëse numri i atyre që arsimohen me orar të plotë nuk është i lartë, përparësia relative e meshkujve krahasuar me femrat është madje edhe më e madhe, në 4.4 përqind ndjekje e arsimit është për më shumë se 80 përqind më e madhe se përqindja ekuivalente për gra.

Grup-mosha	Urban			Rural			Gjithsej		
	Mashkuj	Femra	Gjithsej	Mashkuj	Femra	Gjithsej	Mashkuj	Femra	Gjithsej
5-9	64.9	66.9	65.9	71.0	61.1	66.3	69.4	62.7	66.2
10-14	98.1	96.8	97.4	99.1	96.5	97.8	98.9	96.5	97.7
15-19	73.0	68.4	70.7	69.9	48.5	59.8	70.7	54.0	62.7
20-24	19.6	20.8	20.2	14.2	10.9	12.5	15.8	13.5	14.6
25-29	5.5	7.8	6.7	4.0	0.4	2.0	4.4	2.4	3.3

Tabela 3.6 ofron vështrim të detajuar në ndjekjen e shkollimit duke marrë parasysh vendbanimin. Në moshat 5-14 vjeç, pjesëmarrja në shkollim e fëmijëve rural është më e lartë se sa për fëmijët urban, ndonëse dallimet janë shumë të vogla për të qenë të rëndësishme nga aspekti statistikor. Si me gjinin, dallimet në favor të banorëve urban shfaqen me moshë dhe arsim më të avansuar. Në aspektin e përqindjes dallimi në mes të banorëve rural dhe urban zgjerohet në mënyrë progresive; në grupmoshën 25-29, për banorët urban është pothuajse tri herë më e pritshme të jenë në arsimim me orar të plotë krahasuar me homologët e tyre rural. Natyrisht, kjo nuk reflekton domosdoshmërisht mundësinë e banorëve urban ose rural për të vazhduar arsimin e mëtejshëm. Disa banor rural zhvendosen në zonat urbane për të shfrytëzuar përparësinë e ofruar, dhe duke e bërë këtë, do të rrisin rradhët e atyre që jetojnë në zona urbane dhe i ndjekin studimet universitare.

3.3.2 Analfabetizmi

Ne Kososve, sa I perket edukimit, analfabetizmi është qeshtje e moshes dhe qeshtje gjinore. Nëse analfabetizmi definon ata që nuk dijnë shkrim dhe lexim në asnjë gjuhë, 8 përqind e popullsisë të moshës 15 vite e përtej janë analfabet. Tabela 3.7 paraqet shumë qarte dallimin në mes të gjinive, ku femrat pothuajse katër herë më tepër se meshkujt janë analfabet (12.5 përqind kundër 3.4 përqind). Dallimet gjithashtu ekzistojnë edhe sipas

vendbanimeve; norma e analfabetizmit ne pjeset urbane eshte me e ulet se ajo ne pjeset rurale, sidoqofte keto dallime nuk jane te aq te forta sa dallimet ne mes te gjinive.

<u>Tabela 3.7: Norma e analfabetizmit sipas gjinise dhe vendbanimit</u>			
Perqindja e personave 15 vite e pertej te cilet jane analfabet sipas gjinise dhe vendbanimit, Kosove 2003			
Vendbanimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Urban	2.3	10.4	6.5
Rural	3.8	13.4	8.7
Gjithsej	3.4	12.5	8.1

Gjinia, dhe ne nje nivel me te ulet vendbanimi, qe ndikojne ne analfabetizem jane te nderlidhura edhe me moshe. Norma e pergjithshme relativisht e mire po i maskon grupet tjera me te pafavorshme. Nepermjet kesaj, tek ata te moshes 15-34, analfabetizmi eshte shume I ulet me pak se 2 perqind, pore ashtu si tabela 3.8 po paraqet, tek meshkujt e moshes se re pothuajse ehste zhdukur plotesisht. Tek moshja me e vjeter, analfabetizmi I femrave shifet qarte se eshte nje qeshtje e rendesishme sociale dhe kulturore sipas shtrirjes se gjere qe ka. Ne grupmoshat 55-64, 24 perqind e femrave jane analfabet, krahasuar me mashkujt 4 perqind. Per moshen 64 e pertej 72 perqind te femrave jane analfabet, pothuajse tri here me shume se meshkujt.

<u>Tabela 3.8: Norma e analfabetizmit sipas gjinise dhe moshes</u>			
Perqindja e personave 15 vite e pertej te cilet jane analfabet sipas gjinise dhe moshes, Kosove 2003.			
Grup-mosha	Mashkuj	Femra	Gjithsej
15-24	0.7	2.1	1.4
25-34	1.0	2.4	1.8
35-44	1.3	6.8	4.1
45-54	0.8	9.5	5.2
55-64	4.1	24.3	14.3
64+	25.3	71.7	49.9
Gjithsej	3.4	12.5	8.1

3.5 Punësimi

Të anketuarve u është bërë një numër i pyetjeve për të përcaktuar statusin e punësimit të tyre në kohën e anketës. Disa koncepte janë përfshirë në klasifikimin e aktiviteteve të punës të personave të moshës së punës (në mes 15 dhe 64 vjeç). Anketa ka përvetësuar qasja aktuale në matje, me fokusim në aktivitetet gjatë javës para anketës. Kjo qasje identifikon personat të cilët kanë punuar si të punësuar në një punë për një ose më tepër orë gjatë javës së kaluar. Ata të cilët aktualisht nuk punojnë gjatë javës referente

janë pyetur për aktivitetet e tyre. Personat të cilët kanë thënë se janë duke kërkuar punë janë konsideruar të papunësuar. Anketa ka identifikuar gjithashtu një kategori tjetër të anketuarve të cilët mund të konsiderohen të jenë të papunë për të ndihmuar krahasimin me anketat tjera, megjithatë, këta njerëz, të cilët disa herë përmenden si punëtor të dekurajuar, në përgjithësi nuk janë përfshirë si të papunë.

Prej të dhënave të anketës është e mundshme të matet fuqia punëtore. Kjo përfshinë si ata që janë të punësuar dhe ata të cilët janë të papunë, punëtorët aktual dhe potencial. Siç është treguar në tabelën 3.9, 58 përqind e popullsisë së moshës së punës është ekonomikisht aktive ose në fuqinë punëtore. Kjo përqindje njihet si shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore.

Pjesëmarrja e fuqisë punëtore ndryshon për një numër të arsyeve; moshë, gjinia dhe lokacioni gjeografik i të anketuarve janë faktor të rëndësishëm që e ndikojnë pjesëmarrjen. Për meshkuj, siç mund të shihet nga tabela 3.10 shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në vitin 2003 ishte 76 përqind krahasuar me 40 përqind për femra. Ekzistojnë diferenca gjithashtu sipas vendbanimit, ndonëse këto diferenca janë më pak të theksuara se ato për gjininë. Në vitin 2003 pjesëmarrja ishte 62 përqind krahasuar me shkallën prej 56 përqind për banorët rural.

Kur të krahasohen me rezultatet e anketës së vitit 1999 shihet se shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore ka mbetur shumë e njëtrajtshme. Shkallët urbane dhe rurale krahasohen mirë duke sugjeruar ndryshime të vogla në bazë të vendbanimit. Ndryshimet pozitive duket se janë paraqitur në vitet e fundit drejt barazisë më të madhe gjinore. Shkalla e pjesëmarrjes së meshkujve ka rënë prej 88 përqind në nivelin e tij aktual prej 76 përqind gjatë katër viteve të fundit. Për dallim, shkalla për femra është rritur nga 33 përqind në vitin 1999 në nivelin aktual prej 40 përqind.

Tabela 3.9 Gjendja e aktivitetit ekonomik
Shpërndarja në përqindje e atyre të moshës 15-64 vjeç sipas statusit të punësimit

Gjendja e aktivitetit ekonomik	
Fuqi punëtore-	58
E punësuar	27
E papunë	31
Popullsia ekonomikisht joaktive	42
Gjithsej në moshën e punës	100

Tabela 3.10 Shkallët e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore, 1999 dhe 2003

Shpërndarja në përqindje e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore sipas gjinisë dhe vendbanimit, Kosovë 1999 dhe 2003


Karakteristikat personale	1999	2003
Gjinia		
Meshkuj	88.4	76.2
Femra	33.2	39.9
Vendbanimi		
Rural	54.0	56.0
Urban	61.7	61.6

3.5.1 Popullsia e punësuar

Popullsia e punësuar përfshin ata të cilët kanë punuar gjatë periudhës referente, me ose pa pagesë. Në anketë, 26.3 përqind të personave të moshës 15 gjer në 64 vjeç janë klasifikuar si të punësuar. Megjithatë, tabela 3.11 tregon se kjo shifër mesatare maskon disa variacione të mëdha, posaçërisht në mes të meshkujve dhe femrave. Rrjedhimisht, në përgjithësi 45 përqind e meshkujve të moshës së punës janë të punësuar krahasuar me më


pak se 9 përqind të femrave. Gjersa dallimet nuk janë shumë të theksuara në rastin e vendbanimit ato ende janë evidente. Në mesin e banorëve urban, 33 përqind të atyre që janë në moshë të punës janë të punësuar krahasuar me më pak se 24 përqind të banorëve rural.

Gjinia	Urban	Rural	Gjithsej
Meshkuj	50.7	42.5	44.8
Femra	16.2	5.5	8.6
Gjithsej	33.0	23.6	26.3



Struktura e moshës së popullsisë së punësuar është shumë e ngjashme me atë të përshkruar në raport me tërë fuqinë punëtore. Ndonëse, siç mund të shihet prej shpërndarjeve të paraqitura në figurën 3.3, shkallët e punësimit janë shumë më të ulëta për femra, në mënyrë të ngjashme si te meshkujt ato fillojnë në nivel të ulët, ngriten në kulm në moshat 30-50 vjeç dhe bien shpejtë me rritjen e moshës. Për grupmoshën 60-64 vjeç, dallimet relative janë në vlerat më të larta; pak mbi 1 përqind e grave janë të punësuar krahasuar me 28 përqind të meshkujve.

Punësimi sipas shkollimit thekson rëndësinë e shkollimit në tregun e punës. Siç tregon figura 3.4, me përjashtim të moshave 15-24, ku shumica e njëjërëzve që janë më mirë të arsimuar ende janë duke u arsimuar me orar të plotë, shkallët e pjesëmarrjes janë çdo herë më të larta për ata me arsim të mesëm se sa për ata me arsim fillor, dhe madje edhe më i lartë për ata me arsim universitar. Në të vërtetë, në moshat 35-64 vjeç, personat me shkollim universitar gëzojnë shkallë të pjesëmarrjes përtej 80 përqind, nivele të cilat kurrë nuk arrihen nga grupet tjera. Karakteristikë e shkallëve të pjesëmarrjes për popullsinë me arsim fillor dhe të mesëm është rënia e shpejtë pas moshës 50 vjeç, prapë me dallim të madh me shkallët e rregullta për popullsinë me arsim universitar.



3.5.2 Profesioni

Të gjithë personat të cilët kanë punuar javën e kaluar janë pyetur për profesionin e tyre aktual. Profesionet u klasifikuan dhe u grupuan sipas Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Profesioneve dhe këto janë përmbledhur në tabelat 3.12 dhe 3.13

Disa prej karakteristikave të strukturës së profesionave janë të interesit të veçantë. Pavarësisht nga pjesëmarrja e vogël e grave në fuqinë punëtore, ato që janë të punësuar kanë gjasa më të mëdha se burrat të jenë punët më të larta dhe më të kualifikuara. Rrjedhimisht, më tepër se 31 përqind e grave e përshkruajnë veten si ligjvënës, zyrtar të lartë, menaxher ose profesionistë, përqindje dy herë më e madhe se për meshkuj. Dominimi i meshkujve në zeje dhe profesione të ndërlidhura tregtare dhe në profesionet elementare me kualifikim të ulët me gjasë rezultojnë prej vështirësive për femrat të futen në profesionet e kualifikimit të ulët, duke krijuar dallime në strukturën e moshës të punësimit të cilin po e vëzhgojmë. Nivelet e ulëta të pjesëmarrjes të grave në përgjithësi mbase janë shprehje e mëtejshme e tregut të ndryshëm të punës për burrat dhe gratë.

Ekziston dallimi në mes të banorëve rural dhe urban, por nuk duket të jetë shumë befasues. Klasifikimi i ofruar është i bazuar në kualifikim, dhe pritjet që shpërndarja urbane të kapërcej atë rurale në pesë grupet e para të profesioneve, që reflekton mungesën relative të punëve menaxhuese, profesionale dhe administrative në sektorin rural. Njëjtë jobefasuese është se shpërndarja favorizon sektorin rural në katër profesionet e fundit, të kategorizuara si më pak të kualifikuara, por gjithashtu me përfshirje predominante të punëtorëve bujqësor rural të kualifikuar.

Tabela 3.12 Profesionet e grave
 Shpërndajra në përqindje e grave aktualisht të punësuar sipas profesionit bazuar në karakteristikat personale, Kosovë 2003

Karakteristikat personale	Profesionet									
	Ligjvënës/ Zyrtarë të lartë/ menaxherë	Profesionistë	Teknikë/ Bashkëpunëtorë profesional	Nëpunës	Shitje dhe shërbi me	Bujqë të kualifikuar	Zeje	Operatorë të fabrike dhe makina ve	Elementar	Gjithsej
Mosha										
15-19		9.8	35.3		52.1		2.7			100
20-24	3.4	11.9	33.0	10.4	18.2	16.6	3.5		3.0	100
25-29	1.9	24.1	19.0	6.9	28.2	10.4			9.5	100
30-34	1.7	36.2	12.2	5.5	24.3	2.2	11.0		6.8	100
35-39	4.6	26.1	22.2	11.0	20.7	2.3	10.5		2.5	100
40-44	1.3	25.9	26.5	11.4	25.3	1.3	4.1	1.4	2.8	100
45-49	7.2	41.3	24.7	6.4	13.8	0.2	1.6	1.1	3.7	100
50-54		39.1	13.7	12.5	13.2	9.1	5.2		7.3	100
55-59	3.2	56.7	16.5	8.0	12.2				3.4	100
Vendbanimi										
Urban	2.5	28.6	21.2	10.4	25.5	2.2	5.0	0.7	3.9	100
Rural	4.0	28.0	23.3	6.6	17.9	8.8	5.3		6.1	100
Përkatësia etnike										
Shqiptar	3.6	28.7	21.7	8.1	21.1	6.2	5.9	0.4	4.4	100
Serb	0.8	21.4	26.8	12.2	28.7	0.6	0.9		8.7	100
Tjerë	2.1	42.8	17.6	9.4	19.8	1.7	4.8		2.0	100
Arsimi										
Të pa shkolluar	43.0	6.6			6.1	38.0			6.4	100
Fillor	10.4	10.6	4.5	0.6	26.8	15.9	12.6	0.0	18.9	100
Mesëm	0.3	25.2	27.7	10.7	24.8	3.0	4.8	0.5	2.9	100
Universitar	3.9	68.1	15.4	7.8	4.7					100

Tabela 3.13 Profesionet e burrave

Shpërndajra në përqindje e grave aktualisht të punësuar sipas profesionit bazuar në karakteristikat personale, Kosovë 2003

Karakteristikat personale	Profesionet									Total
	Ligjvënës/ Zyrtarë të lartë/ menaxherë	Profesionistë	Teknikë/ Bashkëpunëtorë profesional	Nëpunës	Shitje dhe shërbi me	Bujqë të kualifikuar	Zeje	Operator të fabrikeve dhe makina ve	Elementar	
Mosha										
15-19	1.1				27.5	18.4	32.7	17.1	3.2	100
20-24	0.2	3.2	2.2	2.0	34.8	18.0	32.8	2.0	4.9	100
25-29	3.3	9.8	5.1	1.6	31.5	7.9	30.4	0.6	9.7	100
30-34	1.4	11.0	5.8	2.9	20.5	14.6	33.5	5.0	5.2	100
35-39	0.7	9.1	7.5	6.1	22.8	11.3	30.1	2.0	10.3	100
40-44	2.8	16.1	6.6	4.4	20.5	12.8	22.3	3.9	10.6	100
45-49	2.2	11.8	9.8	8.7	14.4	6.7	29.4	5.7	11.3	100
50-54	2.3	23.6	7.0	6.0	11.5	17.8	22.3	1.2	8.3	100
55-59	2.3	22.2	6.9	4.6	13.6	13.2	17.0	5.3	14.9	100
60-64	0.1	22.5	12.4	5.4	14.5	15.4	16.5	1.0	12.2	100
Vendbanimi										100
Urban	2.4	13.7	8.9	5.9	29.3	4.3	24.9	3.2	7.4	100
Rural	1.5	11.7	5.1	3.7	18.2	16.7	29.7	3.4	9.9	
Përkatësia etnike										
Shqiptar	1.8	12.0	6.2	4.6	22.5	13.3	27.4	3.1	9.1	100
Serb	1.0	16.3	12.7	3.5	189.8	6.2	28.0	4.5	8.8	100
Tjerë	2.3	13.6	2.6	1.3	13.2	3.6	46.3	9.2	7.7	100
Arsimi										
Të pa shkolluar		3.2			19.1	19.3	39.5		19.0	100
Fillor	1.2	0.3	0.6	0.7	15.2	25.4	37.6	4.6	14.5	100
Mesëm	0.9	10.3	8.3	5.5	27.9	8.4	27.7	3.2	7.8	100
Universitar	9.1	60.5	11.3	9.1	4.9	0.5	3.4	0.9	0.3	100

Kapitulli 4: Fertiliteti

Nga të gjitha gratë e moshës riprodhuese (15-49 vjeç) të intervistuar në anketën e vitit 2003 është kërkuar të japin të plotë historinë e tyre riprodhuese. Në grumbullimin e këtyre historive, secila grua së pari është pyetur nëse ato kanë lindur madje edhe nëse femiu ka lindur i gjallë ose jo. Pas sigurimit të këtyre të dhënave të përmbledhura, janë grumbulluar të dhëna për historinë e shtatëzanive një nga një. Informatat janë grumbulluar rreth shtatëzanisë së fundit të përfunduar, e pastaj për paraprakën, etj. Për secilën lindje janë grumbulluar informata për gjininë e fëmijut, datën e lindjes, statusin e mbijetesës, dhe moshën e vdekjes (për fëmijët të cilët kanë vdekur). Prej informatave të grumbulluara për historitë riprodhuese, është e mundur të vlerësohen nivelet aktuale të fertilitetit, trendet dhe gjithashtu pariteti, si p.sh. numrin e fëmijëve të lindur ndonjëherë nga gratë.

Vështrimi në dëshirën për fertilitet të një popullsie është e rëndësishme, si për parashikimin e fertilitetit të ardhshëm ashtu edhe për vlerësimin e nevojave potenciale të paplotësuara për planifikimin e familjes. Ky kapitull gjithashtu paraqet të dhëna prej anketës të cilat ishin grumbulluar mbi madhësinë e dëshiruar të familjes.

4.1 Fertiliteti aktual

Të dhënat e anketës janë përdorur për të kalkuluar disa matje të fertilitetit, megjithatë historitë e lindjeve të përfshira në anketë me gjasë nuk raportojnë numrin e plotë të lindjeve të cilat kanë ndodhur në vitin e kaluar. Dështimi i anketave për të siguruar mbulim të plotë të ngjarjeve vitale nuk është e pazakonshme dhe shumë prej teknikave të zhvilluara për të vlerësuar fertilitetin prej të dhënave të anketave marrin në konsiderim ato që është e njohur rreth strukturave tipike të gabimeve të raportimit.

Për Kosovën në vitin 2003 Koeficienti i Përgjithshëm i Lindshmërisë (CBR) besohet të jetë 20 në një mijë banorë. CBR është numri vjetor i lindjeve në 1000 banorë. Kjo masë kalkulohet prej të dhënave të historisë së lindjes për periudhën dymbëdhjetë mujore para anketës dhe shpërndarjen e moshës dhe gjinisë së banorëve të ekonomive familjare.

Koeficientët specifik i fertilitetit sipas moshës (ASFR) janë shprehur me numrin e lindjeve të grave të një intervali të caktuar të moshës në 1000 gra të atij intervali të moshës. Në këtë anketë, ASFR është kalkuluar duke e pjesëtuar numrin e lindjeve të grave në intervalin e moshës gjatë periudhës 12 mujore para anketës me numrin e viteve të jetës së grave në atë interval gjatë periudhës së njëjtë 12 mujore. Koeficienti total i fertilitetit (TFR) pastaj kalkulohet duke shtuar ASFR-të aktuale, dhe shumëzuar me pesë pasi që përdoren grupmoshat pesë vjeçare, dhe pastaj pjesëtohet me 1000. TFR interpretohet si numri mesatar i fëmijëve të cilët do të lindeshin nga një grua gjatë jetës së saj nëse ajo do t'i përjetonte ASFR-të aktualisht të vëzhguara. Një karakteristikë e TFR-së është se nuk ndikohet nga shpërndaja e moshës së popullsisë.

Siç tregon tabela 4.2, nëse fertiliteti në Kosovë do të mbes në nivelet aktuale, një grua do të lindte mesatarisht 3 fëmijë gjatë jetës së saj. Fertiliteti në zonat urbane është mjaftë më i ulët se sa në zonat rurale (2.5 me 3.2 fëmijë)


Tabela 4.1 Fertiliteti aktual

Koeficientët e fertilitetit specifik sipas moshës dhe përmbledhës për periudhën 12 mujore para anketës, sipas vendbanimit urban-rural, Kosovë 2003

Moshë	Vendbanimi		
	Urban	Rural	Gjithsej
15-19	0.02329	0.00760	0.01245
20-24	0.15340	0.14376	0.14671
25-29	0.14078	0.24382	0.21291
30-34	0.10432	0.15611	0.14040
35-39	0.05572	0.06056	0.05941
40-44	0.01167	0.03036	0.02338
45-49	0.00095	0.00000	0.00032
TFR	2.5	3.2	3.0

TFR: Koeficientët total të fertilitetit të shprehur për gra

Figura 4.1 Koeficientët Specifik të Fertilitetit sipas Moshës për Gra



Është interesante të krahasohen zonat rurale dhe urbane siç është bërë në figurën 4.1: në dy grupmoshat e para, prej 15 gjer në 25 vjeç, sjellja duket të jetë shumë e ngajshme, edhe nëse fertiliteti është pak më i lartë në zonat urbane dhe arrin kulmin në grupmoshën 20-24 vjeç. Pas moshës 25 vjeç, sjelljet dallojnë shumë. Në zonat rurale, fertiliteti rritet fuqishëm dhe arrin kulmin në mes të moshave 25 dhe 29 vjeç, pastaj bie shpejtë por fertiliteti në moshën 30-34 vjeç është ende baraz me fertilitetin e moshës 20-24 vjeç. Në zonat urbane, fertiliteti fillon të bie ngadal pas moshës 25 vjeç dhe arrin nivelin e njëjtë si në zonat rurale në grupmoshën 35-39 vjeç.

Struktura e koeficientëve specifik të fertilitetit sipas moshës është tipike sa i përket ndikimeve të martesës së vonuar. Fertiliteti i ulët në moshat 15-19 vjeç ilustron një proporcion të madh dhe në rritje të grave të cilat mbesin beqare në atë grupmoshë. Rënia e shpejtë e fertiliteti në moshat më të vjetra reflekton si rënien e fertilitetit ashtu edhe përdorimin e vazhdueshëm të metodave të planifikimit të familjesë për të evituar lindjen e fëmijëve. Në anketën e vitit 1999 TFR për vitin 1998 është raportuar të jetë 2.7. Ndonëse nuk është e zakonshme për fertilitetin që të rritet disa studime thonë se nuk është e pazakonshme rritja e shpejtë e fertilitetit pas gjendjeve të konfliktit¹.

4.2 Fëmijët e lindur dhe që jetojnë

Fertiliteti i të kaluarës mund të kuptohet kur të merret në konsiderim fertiliteti i grave të vjetra, si p.sh. i grave të moshës 45-49, pasi që fertiliteti i tyre mund të konsiderohet i përfunduar. Tabela 4.2 paraqet shpërndarjen e të gjitha grave sipas numrit mesatar të fëmijëve të lindur sipas vendbanimit. Fertiliteti i përfunduar i grupit të grave të lindura në mes të vitit 1954 dhe 1958 në mesatare është 4.6 në zonat rurale dhe 3.3 në zonat urbane: këta numra korrespondojnë me nivele shumë të larta të fertilitetit.

Tabela 4.2 Fëmijët e lindur			
Numri mesatar i fëmijëve të lindur për gra sipas grupmoshave pesëvjeçare, Kosovë 2003			
Grupmosha	Vendbanimi		Gjithsej
	Urban	Rural	
15-19	0.024	0.009	0.015
20-24	0.378	0.312	0.344
25-29	1.291	1.455	1.411
30-34	2.016	2.696	2.485
35-39	2.890	4.057	3.753
40-44	3.286	3.752	3.606
45-49	3.143	4.550	4.070

Rënia e fertilitetit mund të analizohet duke krahasuar fertilitetin e përfunduar me TFR-në aktuale. Nëse nuk ka pasur ndryshime në fertilitet gjatë periudhës para anketës, treguesi i fertilitetit aktual (TFR) dhe treguesi i fertilitetit të grupit (numri mesatar i fëmijëve të lindur për gra të moshës 45-49 vjeç) do të jenë përafërsisht të barabartë. Nëse fertiliteti ka rënie, atëherë fertiliteti aktual do të jetë më i vogël se fertiliteti i grupit, me dallime të mëdha që tregojnë një rënie më rapide. Në tabelën 4.3 janë krahasuar këto masa dhe është

e qartë se fertiliteti është mjaftë më i ulët se fertiliteti i grupit. Kjo provë indirekte e rënies së fertilitetit është posaçërisht e theksuar në zonat rurale, ku TFR-ja aktuale 3.21 e të cilave është 30 përqind më e ulët se numri mesatar e fëmijëve të lindur për gratë rurale të moshës 45-49 vjeç.

Grupmosha	Urban	Rural	Gjithsej
CEB (gratë 45-49 vjeç)	3.14	4.55	4.07
TFR	2.45	3.21	2.98

Siç është deklaruar në raportin e anketës së vitit 1999, këto nivele të fertilitetit e bëjnë Kosovën një prej regjioneve më të pleshme në Evropë. Megjithatë, provat e paraqitura në këtë kapitull, të cilat fuqishëm tregojnë se fertiliteti është në rënie, duke sugjeruar se fertiliteti i Kosovës me kohën mund të pushoj së qeni i dallueshëm.

4.3 Preferencat për fertilitet


Në anketë nga gratë është kërkuar të deklarojnë se sipas mendimit të tyre cila është madhësia ideale e familjes. Këto informata janë siguruar duke i shtruar të anketuarve dy pyetje. Të anketuarit të cilët nuk kanë pasur fëmijë janë pyetur, “Nëse mund të zgjedhni saktësisht numrin e fëmijëve që do të keni në tërë jetën tuaj, sa do të ishte ky numër?”. Për të anketuarit të cilët tashmë kishin fëmijë, pyetja ishte “Nëse do të kishit mundur të ktheheni në kohën kur nuk kishit fëmijë dhe do të mund të zgjidhni numrin e saktë të fëmijëve që do të keni në tërë jetën tuaj, sa do të ishte ky numër?”. Përgjigjet në këto pyetje ishin paramenduar që të jenë të pavarura nga numri i fëmijëve të cilët i anketuari tashmë i ka. Megjithatë, zakonisht ekziston korelacioni në mes të numrit aktual të fëmijëve të cilët i ka i anketuari dhe idealit të tyre të raportuar.

Tabela 4.5 tregon se praktikisht të gjithë Kosovarët dëshirojnë familje me disa fëmijë. Numri mesatar i fëmijëve të dëshiruar rritet vazhdimisht me moshën e grave. Gjithashtu është e dukshme se gratë rurale dëshirojnë më shumë fëmijë se gratë urbane. Kështu, duke pasur parasysh efektet e kombinuara të arsimit dhe vendbanimit, janë gratë e reja urbane ato të cilat dëshirojnë familjet më të vogla dhe gratë e vjetra rurale ato të cilat i dëshirojnë familje më të mëdha.

Grupmosha	Urban	Rural	Gjithsej
15-19	2.4	2.6	2.5
20-24	2.7	2.9	2.8
25-29	2.9	3.1	3.0
30-34	3.1	3.5	3.4

35-39	3.3	3.8	3.7
40-44	3.5	3.9	3.8
45-49	3.7	4.6	4.3
Gjithsej	3.0	3.3	3.2

Ndikimi i arsimit në nurin ideal të fëmijëve është shumë i qartë dhe është treguar në figurën 4.2. Në të gjitha nivelet e arsimit, gratë urbane dëshirojnë më pak fëmijë se gratë rurale. Më befasuese është se gratë e pashkolla dëshirojnë më së shumti fëmijë, mesatarisht më tepër se 4. Gratë me shkollim të mesëm ose më të lartë dëshirojnë më pak, mesatarisht më pak se 3.




Të pyetur për numrin e djemve dhe vajzave që i dëshirojnë, të anketuarit tregojnë preferenca të dukshme për djem. Familja mesatare ideale e raportuar nga të gjithë të anketuarit përbëhet nga 1.7 djem, 1.4 vajza dhe 0.1 fëmijë ku i anketuari deklaron se gjinia e fëmijës nuk paraqet dallim. Zgjedhjet e tilla tregojnë se gratë mesatarisht dëshirojnë 22 përqind më tepër djem se sa vajza në familjet e tyre ideale.

Grupmosha	Urban		Rural		Gjithsej	
	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza
15-19	1.2	1.0	1.4	1.2	1.3	1.1
20-24	1.4	1.2	1.5	1.2	1.5	1.2
25-29	1.5	1.3	1.7	1.3	1.7	1.3
30-34	1.6	1.4	1.9	1.5	1.8	1.5
35-39	1.7	1.5	2.0	1.6	2.0	1.6
40-44	1.8	1.6	2.1	1.7	2.0	1.7
45-49	1.9	1.6	2.4	2.1	2.3	1.9
Total	1.6	1.3	1.8	1.4	1.7	1.4


Siç sqarohet nga tabela 4.6, në Kosovë gratë fshatare dëshirojnë më shumë fëmijë sesa gratë urbane. Gratë më të vjetra dëshirojnë më shumë fëmijë sesa grate e reja dhe të gjitha gratë dëshirojnë djemtë më shumë sesa vajzat.

Shpërndarja e ndryshimeve të përqindjes në mes të numrit të djemve të dëshiruar dhe numrit të vajzave është shumë interesante. Vështrimi se gratë më të reja kanë më pak preferenca për gjini, është konsistent me llojet e ndryshimeve në sjellje të vërejtura në kapitujt të tjerë dhe është plotësisht e pritur. Rënia në preferencat e gjinisë pas moshës 30 vjeçare e treguar në figurën 4.3, është pak e befasishme, për shkak të nivelit të ultë arsimor të grave më të vjetra dhe çka mund të mendohet si sjellje tradicionale sa i përket krijimit të familjes. Pse preferencat e gjinisë janë aq të forta në mes të moshës 25 dhe 35 vjeç, e pse dobësohen më pas, është pyetje që kërkon më shumë hulumtim.




⁸ Për të lehtësuar prezantimin, është përjashtuar përqindja e rasteve kur të anketuarit thonë se gjinia e fëmijës nuk paraqet ndonjë dallim

Ndikimi i arsimimit në preferencat për gjini nuk është aq i qartë pasi që ndikohet nga numri ideal i fëmijëve. Figura 4.4 paraqet dëshirën më të madhe për djem në mënyrë ngjashme me figurën 4.3. Në përgjithësi duket se arsimimi ndikon idealet rreth madhësisë së familjes dhe përbërjen. Sidoqoftë gratë në të gjitha nivelet e arsimit gjer në, dhe duke përfshirë shkollën e mesme dhe të lartë, tregojnë dëshirë konstante më të madhe për djem, në mbi 20%. Vetëm gratë me arsim univerzitar tregojnë një ndryshim dhe ai ndryshim është shumë i dallueshëm. Gratë me arsim univerzitar tregojnë dëshirë më të madhe për djem në 9%, më pak sesa gjysma e grave tjera.



Të anketuarit janë pyetur nëse partnerët e tyre dëshirojnë numrin e njëjtë, ose më shumë ose më pak fëmijë se ato. 91% e grave thonë se partnerët e tyre dëshirojnë numrin e njëjtë ose nuk dijnë, përderisa kjo është e ngjashme edhe te gratë fshatare edhe ato urbane, një përqindje më e madhe e grave fshatare sesa e grave urbane nuk pajtohen me burrat e tyre. Kjo është e vërtetë edhe për ato që thonë se burrat e tyre dëshirojnë më pak dhe për ato se thonë se burrat e tyre dëshirojnë më shumë. Siç tregon figura 4.5, kur burrat dhe gratë nuk pajtohen, burrat ka gjasa të dëshirojnë më shumë fëmijë sesa gratë e tyre.



Kapitulli 5: Vdekshmëria

5.1 Sfondi dhe vlerësimi i kualitetit të të dhënave

Ky kapitull paraqet informatat e marra nga anketa e vdekshmërisë së të rriturve dhe të foshnjeve. Ndryshimet e vdekshmërisë janë të dobishme për agjencitë që ofrojnë shërbime shëndetësore sepse ato identifikojnë nën-grupet e popullsisë në të cilat rreziku i vdekjes është i lartë. Kualiteti i të dhënave të grumbulluara për vdekshmërinë sidoqoftë nuk është aq i mirë sa është pritur. Prandaj është i domosdoshëm rregullimi i të dhënave të grumbulluara. Përdorimi i metodave klasike të rregullimeve janë bërë të vështira, për shkak të panjohurisë së popullsisë së Kosovës: supozimi se stabiliteti i kaluar i popullsisë vështirë se mund të konsiderohet si i aplikueshëm, për shkak të migrimeve masive të fundit që kanë ndryshuar seriozisht shpërndarjen sipas moshës dhe gjinisë. Shumë teknika të përdorura në kapitull janë paksa teknike, edhe pse analizat mendohet të ofrojnë vetëm shkallat më themelore.

Secili prijës i ekonomisë familjare është pyetur për të dhënë detajet e vdekjeve në ekonomi familjare gjatë 12 muajve para anketës. Dihet mirë se për shumë arsye njerëzit janë shpesh ngurues të flasin rreth vdekjeve dhe pyetjet e pandryshuara të këtij lloji nuk mbulojnë të gjitha rastet. Përveç kësaj, vdekjet në ekonomitë familjare një personëshe dhe vdekjet në ekonomitë familjare që më pas emigrojnë, janë lënë anash në tërësi. Kjo shkallë e ultë e raportimit rezulton pashmangshëm në shkallë të nënvlerësuar të vdekshmërisë.

Siç përmendet në kapitullin 3, pyetëtori përfshinë një histori riprodhuese ku janë shtruar pyetjet rreth rezultateve të secilës lindje. Lindja e gjallë është definuar si çdo lindje, pa marrë parasysh kohëzgjatjen e shtatëzarisë, pas ndarjes së të foshnjës nga nëna duke treguar shenja të jetës. Vdekja e foshnjës është definuar si vdekje e fëmijut të lindur gjallë i moshën nën një vjeçare. Për çdo lindje të gjallë të raportuar në historinë e shtatëzarisë, janë shtuar pyetjet rreth datëlindjes (muaji dhe viti), gjinisë, mbijetesës, dhe moshës aktuale (për fëmijët që kanë mbetur gjallë) ose moshës së vdekjes (për fëmijët e vdekur). Llogaritë e vdekshmërisë për periudhat e caktuara para anketës janë kalkuluar nga kjo informatë.

Saktësia e llogarive të vdekshmërisë varen nga variabiliteti i mostrimit për llogaritje dhe nga tërësia dhe saktësia me të cilat janë raportuar dhe regjistruar lindjet dhe vdekjet (kjo njihet si gabim para-mostrimit). Në mënyrë tipike në anketat retrospektive (prapavështruese), ka gjasë që gratë të raportojnë më pak lindje dhe vdekje të fëmijëve të cilët nuk kanë mbijetuar. Nën-raportimi i fëmijëve të vdekur zakonisht është më i madh për vdekjet që ndodhin në fëmijërinë e hershme (dmth periudha e posalindur). Nën-raportimi i vdekjeve të posalindurve rezulton në shkallë jonormalisht të ultë të vdekshmërisë së të posalindurve në vdekshmërinë e foshnjeve.

Përkundër këtyre mangësive, disa prej së cilave mund të tejkalohen duke përdorur metodat përkatëse demografike, pyetjet e përfshira në anketë sa i përket vdekshmërisë ende mund të ofrojnë disa informata të dobishme.

5.2 Vdekjet në ekonomi familjare në 12 muajt e kaluar

Shkalla e përgjithshme e vdekshmërisë (SHPV) paraqet numrin vjetor të lindjeve për një mijë banorë. Kjo kalkulohet nga të dhënat për 12 muajt para anketës dhe shpërndarja për nga mosha dhe gjinia e popullsisë së ekonomisë familjare. Nga të dhënat, shkalla e SHPV kalkulohet të jetë 5.4 për një mijë banorë. Për shkak të njohurisë empirike në dispozicion për neglizhimet e vdekjeve nga kjo pyetje, SHPV e vërtetë do të jetë mesiguri së paku 6 e ndoshta afër 7-shit. SHPV konfirmon se aktualisht sistemi vital statistikor në Kosovë nuk është duke kapur të gjitha rastet e vdekjeve në Kosovë.

Nëse përdorim atë çka dimë rreth SHPV-së 20 për një mijë) e pastaj gjithashtu edhe shkallën e rritjes natyrore⁹ (14.6 për një mijë) për zgjedhjen e modelit të tabelës së jetës nga modeli Princeton i tabelës së jetësⁱⁱ, gjejmë se korrespondojnë në vdekshmëri shumë të ultë, pa marrë parasysh regjionin të cilit i referohen. Jetëgjatësia e pritur në lindje mund të llogaritet të jetë rreth 75 vite.

Tabela 5.1 paraqet shpërndarjen e vdekjeve në ekonomi familjare për nga mosha e vdekjes. Edhe përkundër neglizhimeve, shpërndarja e vdekjeve për nga mosha sipas të gjitha gjasave reflekton me saktësi moshat e vdekjes. Për shembull, tabela 5.1 ilustron koncentrimin e vdekjeve në moshën e hershme, zvogëlimin e vdekshmërisë në vitet e adoleshencës, që ngadal rritet në vitet e hershme të reproduksionit përmes vdekshmërisë së lehonave, luftës dhe aksidenteve e pastaj rritet dukshëm për nga mosha mbi moshën pesëdhjetë vjeçare.

Tabela 5.1 Vdekjet në vitet e fundit	
Shpërndarja në përqindje e vdekjeve në ekonomi familjare në vitet e kaluara në bazë të moshës, Kosovë 2003	
Grupmosha	Vdekjet
0-9	15.6
10-19	0.4
20-29	2.8
30-39	2.9
40-49	2.1
50-59	4.4
60-69	19.6
70 e mbi	52.2
Gjithsej	100

⁹ Shkalla e rritjes natyrore = Shkalla e përgjithshme e vdekshmërisë – koeficienti i përgjithshëm i lindshmërisë

5.3 Llogaritjet e vdekshmërisë nga fëmijët që kanë vdekur

Përderisa numri i fëmijëve të vdekur të raportuar nga nënat nuk është i madh dhe raportimi i nënshtrohet gabimeve të mostrimit dhe mos-mostrimit, nga të dhënat e raportuara, mund të kalkulohej këto shkallë:

- Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve = 23.7 për 1000
- Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve (vdekjet nën 5 vite) = 42 për 1000

Duke u referuar modelit të Princeton për tabelat e jetesës (regjioni lindor), shkalla e tillë e vdekshmërisë së foshnjeve do të korrespondoj në jetegjatësi gjer në 79 vite; dhe shkalla e tillë për vdekje të foshnjeve do të korrespondoj në jetegjatësi gjer në afër 67 vite. Këto rezultate konfirmojnë se llogaritjet e vdekshmërisë të nxjerra nga vështrimi i një numri të vdekjeve (të personave në të gjitha moshat) që janë paraqitur gjatë 12 muajve para anketës, janë nënvlerësuar. Pastaj, vet pyetësi ka paraqitur paragjykim: vetëm gratë nën moshën 50 vjeçare janë intervistuar rreth fertilitetit të tyre gjatë anketës; prandaj për analiza retrospektive (prapavështruese), lindjet dhe vdekjet nga gratë 50 vjeçare ose mbi në kohën e anketës nuk mund të mirren në konsideratë.

5.4 Shkalla e mbijetesës së fëmijëve të lindur– shkallat e rregulluara

Duke përdorur të dhënat e vështuara, raporti i fëmijëve ndonjëherë të lindur që kanë vdekur do të jetë zero te nënat nën 20 vjeçe. Kjo krijon problem të madh, pasi që metoda për llogaritjen e vdekshmërisë së foshnjeve nga përpjestimi i foshnjeve të vdekura bazohet në këto të dhëna. Pastaj, shpërndarja e përpjestimit të vdekjes së fëmijëve flukton shumë nga një grupmoshë në tjetrin siç paraqitet në tabelën 5.2. Këto përpjestime duhet rregullohen për shkak të nën-raportimit, para se të përdoren për kalkulim të koeficientit të vdekshmërisë.

Tabela 5.2 Raporti i fëmijëve të lindur që kanë vdekur, për nga mosha e nënës dhe vendi i banimit

Mosha e nënës	Urbane	Rurale	Së bashku
15-19	0	0	0
20-24	0,02233	0,03645	0,03081
25-29	0,03435	0,03050	0,03146
30-34	0,01627	0,06038	0,04920
35-39	0,03246	0,07752	0,06846
40-44	0,03623	0,06320	0,05552
45-49	0,04685	0,06249	0,05838

Nga të gjitha të anketuarët në anketë është kërkuar të japin historinë complete të lindjeve të tyre, përfshirë gjininë, muajin dhe vitin e lindjes, mbijetesën, dhe moshën në kohën e

anketës ose moshën e vdekjes për secilin fëmijë të lindur gjallë. Kjo informatë është përdorur për të kalkuluar raportin e fëmijëve të vdekur që kanë lindur gjallë për nga mosha e nënës.

Metoda përfshinë zvogëlimin e probabilitetit të vdekjes në mes të lindjes dhe datëlindjes së parë, në mes të lindjes dhe datëlindjes së dytë, në mes të lindjes dhe datëlindjes së tretë dhe në mes të lindjes dhe datëlindjes së katërt, nga raporti i fëmijëve të vdekur që janë lindur gjallë nga nënat në moshat respektive 15-19, 20-24, 25-29 dhe 30-34 vjeçe.

Për arritjen e konvertimit përkatës, zbatohet një pako e faktorëve konvertues $a(x)$, $b(x)$, $c(x)$ në dy indikatorë të fertilitetit të hershëm: raporti i paritetit të moshës së grave në mes 15-19/20-24 vjeçe e pastaj të paritetit të grave të moshës në mes 20-24/25-29 vjeçe. Faktorët konvertues janë aplikuar në raportet e vdekjes si më poshtë:

$$Q(i) = a(x)*[P15-19/P(20-24)] + b(x)*[P(20-24)/P(25-29)] + c(x)$$

Pakot e faktorëve konvertues ekzistojnë për çdo tabelë regjionale të modelit jetësor të tabelave të modelit jetësor të Coale dhe Demenyⁱⁱⁱ; këtu kemi përdorur tabelat model të jetesës së Regjionit Lindor. Nga përdorimi i metodës Coale dhe Trussel^{iv} dhe tabelat jetësore model Princeton – regjioni lindor^v si referencë, janë gjetur këto probabilitete të vdekjes:

Tabela 5.3 Probabiliteti i vdekjes			
Probabiliteti i vdekjes në mes të lindjes dhe moshës së saktë të fëmijut dhe vendbanimi - (të dhënat e rregulluara)			
Mosha e saktë i	Urbane	Rurale	Gjithsej
1	0,00000	0,00000	0,00000
2	0,02522	0,04236	0,03692
3	0,03645	0,03314	0,03390
5	0,01710	0,06470	0,05238
10	0,03464	0,08421	0,07391
15	0,03802	0,06748	0,05892
20	0,04870	0,06606	0,06134

Probabiliteti i vetëm që duket të jetë i besueshëm është vdekshmëria nën-pesë: ${}_5q_0$. Sidoqoftë duket se është nënvlerësuar (për shkak të nivelit shumë të ultë të kalkuluar për zonat urbane). Nëse supozojmë se ${}_5q_0 = 60$ për njëmijë atëherë të jetëgjatësia në lindje është rreth 65 vite. Vlera e ${}_5q_0$ për zonat rurale duhet të konsiderohen për analiza të tutjeshme.

Pas ekstrapolimit, janë raportuar 35823 lindje të gjalla gjatë 12 muajve të fundit para anketës, prej së cilëve 1.171 kanë vdekur. Duke supozuar se shpërndarja e vdekjeve të foshnjeve gjatë vitit të parë është dy të tretat, dhe pastaj një e treta në periudhën e dytë 12 mujore, numri i përgjithshëm i vdekjeve para datëlindjes së parë bëhet 1757, kur ato kanë rezultuar nga 35823 lindje të gjalla. Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve llogaritet si:

$1q_0 = 49$ për njëmijë

Pyetja për numrin e vdekjeve të raportuara gjatë 12 muajve të kaluar para anketës ka dhënë numër shumë më të vogël: janë raportuar vetëm 848 vdekje të foshnjeve, në krahasim me 1757 më lartë; kjo çon në shkallë shumë të ultë “të shkallës së raportuar” prej vetëm 48%. Duke supozuar se ky nën-raportim ka ndikuar fëmijët nën 1 vjet, dmth duke korrigjuar vetëm vdekjet e fëmijëve nën 1 vjet e jo ato të fëmijëve në mes 1-4 vjet, kalkulojmë:

$5q_0 = 62$ per thousand

5.5 Përfundimet për llogaritjet e vdekshmërisë

Shkallat e rregulluara besohen të jenë më reale sesa shkallat që rezultojnë nga të dhënat e vështruara. Fatkeqësisht këto rezultate paraqesin një pasqyrë relativisht të zbehtë për Kosovën. Duhet të shprehet se këto rezultate, aktualisht janë shumë tentative e jo konkrete dhe niveli real i mortalitetit ka gjasa të qëndroj diku në mes shkallës së raportuar dhe rregulluar. Sidoqoftë me mundësi të shkallës së tillë të lartë të vdekshmërisë së foshnjeve që është prezente në Kosovë, nevoja për hulumtime të tutjeshme është thelbësore.

Kapitulli 6: Kontraceptivët

Ky kapitull paraqet rezultatet e anketës sa i përket aspekteve të ndryshme të njohurisë dhe sjelljeve ndaj kontraceptivëve. Pyetjet për kontraceptivë janë shtruar të gjitha grave në moshë në mes 15 dhe 49. Temat e adresuara në këtë kapitull përfshijnë njohurinë për metodat kontraceptive, përdorimi i metodave tani dhe në të kaluarën, vendet prej ku furnizohen me kontraceptivë dhe përvoja e ndikimeve anësore.

6.1 Njohuria për kontraceptivë

Për të marrë të dhënat për njohurinë dhe përdorimin e planifikimit të familjes, anketuesi ka lexuar listën e dhjetë metodave të planifikimit të familjes dhe ka pyetur të anketuarit nëse kanë dëgjuar secilën metodë. Metodatat kontraceptive përfshijnë metodat moderne dhe tradicionale. Metodatat moderne përfshijnë pilulat, IUD (bobinë bakri), injeksionet, sterilizimin e meshkujve dhe femrave, diafragma, shkuma, gelli dhe kondomi i mashkujve. Metodatat tradicionale përfshijnë metodën ritmike/abstenimi periodik dhe tërheqja. Përveç këtyre metodave, anketuesi ka qenë në gjendje që të regjistroj në pyetësorë çfarëdo metode të përmendur në mënyrë spontane nga i anketuari.

Siç tregohet në tabelën 6.1, njohuria për kontraceptivë është afro univerzale në mesin e grave kosovare, 97.5% ka dëgjuar së paku një metodë. Njohuria është më e larta në mesin e grave aktualisht të martuara (99%).

Tabela 6.1 Njohuria për metoda kontraceptive		
Përqindja e të gjitha femrave dhe grave aktualisht të martuara që dijnë për çfarëdo metode kontraceptive, për nga metodat specifike, Kosovë 2003		
Metoda kontraceptive	Të gjitha gratë	Gratë aktualisht të martuara
Çfarëdo metode	97.5	99.0
Cilëndo metodë moderne		
Pilula	86.8	89.5
IUD	86.3	89.5
Injeksion	61.2	65.7
Diafragmë	33.4	36.1
Shkumë, gell	33.9	36.8
Kondom	76.0	76.0
Sterilizim i femrës	47.4	52.3
Sterilizim i mashkullit	32.0	33.9
Cilëndo metodë tradicionale		
Ritmik	46.2	51.8
Tërheqje	68.5	78.9
Cilëndo metodë tjetër	5.3	5.1
Numri mesatar i metodave të njohura	6.3	6.7

Sa i përket njohurisë së metodave specifike, 89.5 % e grave aktualisht të martuara kanë dëgjuar edhe për pilula edhe për IUD. 76% kanë dëgjuar për kondomin e mashkullit, kjo është një rritje prej 17.7% që nga viti 2000 që ndoshta reflekton përpjekjet e marketingut social të kondomëve që ka qenë në ngritje në Kosovë. Tërheqja është më e njohura sa i përket metodave tradicionale (78.9%). Mesatarisht gratë kosovare njohin 6.3 të metodave kontraceptive.

Tabela 6.2 për nga karakteristikat e personale tregon përqindjen e grave aktualisht të martuara që dijnë së paku një metodë kontraceptive. Me përjashtim të grupmoshave të reja, njohuria për cilëndo metodë dhe për metodat moderne nuk ndryshon për nga mosha dhe është praktikisht univzale. Megjithatë ndryshimet për nga vendbanimi janë të shprehura. Edhe pse shumëllojshmëria e përgjithshme është e ngjashme për të gjitha metodat, gratë urbane ka gjasa të kenë dëgjuar rreth tyre sesa gratë fshatare.

Tabela 6.2 Njohuria për metodat kontraceptive për nga karakteristikat personale			
Shpërndarja në përqindjen e të gjitha grave që dijnë metodat kontraceptive për nga mosha, vendbanimi, etniteti dhe arsimimi			
Karakteristikat personale	Dijnë cilëndo metodë	Dijnë cilëndo metodë moderne	Numri i grave
Mosha			
15-19	92.8	90.8	797
20-24	97.7	97.0	817
25-29	99.0	97.8	769
30-34	98.3	96.2	688
35-39	98.5	97.6	592
40-44	99.1	98.7	394
45-49	98.2	96.2	553
Vendbanimi			
Urban	98.8	98.7	2 663
Rural	95.7	95.2	1 947
Etniteti			
Shqipëtar	96.0	95.6	4 033
Serbisht	98.3	97.0	432
Tjetër	97.6	95.9	145
Arsimimi			
Pa shkollë	77.0	74.6	144
Shkollë fillore ¹⁰	96.0	95.6	2 499
Shkollë e mesme dhe e lartë ¹¹	98.9	98.7	1 823
Univerzitet e mbi	98.9	98.9	141

¹⁰ Ky nivel përfshinë tri kategori të përgjegjeve të ofruara në pyetësorë: më pak se fillor 1-4, më pak se fillor 5-7, dhe me fillore të përfunduar

¹¹ Ky nivel përfshinë katër kategori të përgjegjeve të ofruara në pyetësor: të mesme 1-3, mesme 4 e më shumë, gjimnaz dhe shkollë e lartë

6.2 Përdorim i kontrceptivëve

Për secilën metodë që i anketuari thotë të ketë dëgjuar, ajo është pyetur nëse ka përdorur ndonjëherë atë metodë. Rezultatet janë paraqitur në tabelën 6.3 për të gjitha gratë e moshës riprodhuese për nga grupmoshat pesë vjeçare.

Pothuaj pesë nga dhjetë gra kanë përdorur një metodë kontrceptive gjatë jetës së tyre; 37% e të gjitha grave kanë raportuar se janë seksualisht joaktive. Më shumë gra kanë provuar metodën tradicionale të kontrceptivëve sesa metodën moderne. Metoda më e zakonshme larg nga të tjerat, është tërheqja. Përdorimi i tërheqjes (48.9%) tejkalon faktorin 4 krahasuar me përdorimin e kondomit (12.2%).

Tabela 6.3 Përdorimi i kontrceptivëve

Përqindja e të gjitha grave dhe grave aktualisht të martuara që kanë përdorur ndonjë metodë kontrceptive, për nga metodat specifike dhe moshja, Kosovë 2003

Moshë	Cilado metodë	Metodë moderne								Metodë tradicionale			Metodë tjetër	Numri i grave
		Cilado metodë moderne	Pilulë	IUD	Injeksione	Kondom	Sterilizim i femrës	Diafragma	Shkumë/gel	Cilado metodë tradicionale	Abstenimi periodik	Tërheqja		
TË GJITHA GRATË														
15-19	5.3	33.1	9.3	17.4	0.0	14.5	4.1	0.0	0.0	66.8	6.7	46.7	1.2	714
20-24	17.4	32.3	4.2	6.6	1.3	17.3	0.5	1.9	2.6	67.6	9.1	56.1	0.3	804
25-29	44.7	39.4	8.3	12.4	1.6	13.3	1.3	1.2	1.9	60.5	7.7	52.3	0.0	758
30-34	66.3	43.2	7.1	15.6	0.9	13.6	0.5	2.3	3.3	56.7	10.3	46.4	0.0	677
35-39	81.7	42.0	9.8	17.0	0.3	10.8	3.0	0.6	0.6	58.0	9.1	48.9	0.0	588
40-44	84.0	46.6	8.9	19.0	1.6	11.9	2.6	1.2	1.1	53.2	7.8	45.9	0.0	548
45-49	73.2	42.3	10.2	17.5	0.1	9.0	2.9	1.2	1.0	57.4	7.5	50.1	0.2	391
Total	48.6	42.2	8.5	15.8	0.9	12.2	2.0	1.3	1.6	57.7	8.6	48.9	0.1	4 482

6.3 Përdorimi aktual i kontrceptivëve

Për të gjitha metodat, gratë që raportuan se kanë përdorur ndonjëherë në jetën e tyre, janë pyetur nëse ende përdorin atë metodë tani. Tabela 6.4 paraqet nivelet e përdorimit aktual të kontrceptivëve për të gjitha gratë dhe për gratë aktualisht të martuara, 35% e grave në moshën riprodhuese aktualisht janë duke përdorur metoda kontrceptive. Pothuaj të gjithë shfrytëzuesit aktualisht janë gra të martuara. Në moshat më të reja, niveli i përdorimit të kontrceptivëve është i ultë, që reflekton numrin e grave të pamartuara në grupmoshat më të reja dhe pa planifikim të familjes në martesën e hershme.

Tabela 6.4 Përdorimi aktual i kontraktivëve

Përqindja e të gjitha grave dhe grave aktualisht të martuara për nga metoda e përdorur kontrceptive, në bazë të moshës, Kosovë 2003

Moshë	Cilado metodë	Metoda moderne								Metoda tradicionale			Metodë tjetër	Numri i grave
		Cilado metodë moderne	Pilulë	IUD	Injeksione	Kondom	Sterilizim i femrës	Diafragma	Shkumë/gel ¹	Cilado metodë tradicionale	Abstenimi periodik	Tërheqja		
TË GJITHA GRATË														
15-19	1.7	0.8	0.7	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	1.0	0.1	0.9	0.0	714
20-24	12.3	3.2	0.3	0.9	0.2	1.4	0.0	0.2	0.2	9.1	0.2	8.9	0.0	804
25-29	34.8	12.0	1.9	5.1	0.7	3.5	0.4	0.1	0.3	22.7	0.6	22.1	0.1	758
30-34	44.8	20.7	4.2	11.4	0.1	3.9	0.3	0.3	0.5	24.0	1.3	22.7	0.0	677
35-39	64.1	28.7	5.7	15.7	1.1	3.5	2.1	0.0	0.6	35.4	1.8	33.6	0.0	588
40-44	56.2	26.3	5.2	13.8	0.8	5.0	0.9	0.4	0.2	29.8	1.4	28.4	0.0	548
45-49	53.8	19.7	4.9	9.3	0.8	1.1	2.5	0.6	0.5	33.9	1.2	32.7	0.0	391
Total	35.0	14.5	2.9	7.3	0.5	2.6	0.7	0.2	0.3	20.5	0.9	19.6	0.0	4 482
GRATË AKTUALISHT TË MARTUARA														
15-19	33.9	10.4	7.8	0.0	0.0	2.6	0.0	0.0	0.0	23.6	1.6	22.0	0.0	41
20-24	32.2	8.4	0.9	2.4	0.6	3.5	0.0	0.5	0.5	23.7	0.6	23.1	0.0	315
25-29	47.7	16.0	1.9	7.2	0.9	4.8	0.6	0.1	0.5	31.6	0.9	30.7	0.2	536
30-34	52.3	24.1	4.9	13.3	0.1	4.5	0.3	0.4	0.6	28.1	1.6	26.5	0.0	551
35-39	69.9	31.4	6.2	17.2	1.2	3.9	2.3	0.0	0.6	38.6	2.0	36.6	0.0	535
40-44	62.1	29.2	5.8	15.3	0.9	5.5	1.0	0.5	0.2	33.0	1.6	31.4	0.0	482
45-49	58.5	21.5	5.4	10.2	0.8	1.2	2.7	0.6	0.6	37.0	1.4	35.6	0.0	347
Total	54.9	22.6	4.3	11.5	0.8	4.1	1.1	0.3	0.5	32.3	1.4	30.9	0.0	2 807

Nga përgjegjet është e mundshme të mirret Koeficienti Kontraktiv i Prevalencës (KKP)¹². Në përgjithësi 54.9% e grave aktualisht të martuara janë duke përdorur një metodë të planifikimit familjar, kjo është gati dyfishi i KKP në vitin 1999 (32.2%). Ky është rezultat befasues dhe nuk ka gjasa që ndryshimi i tillë në sjellje të jetë paraqitur në të vërtetë në hapësirën e katër viteve. Arsye e mundshme për këtë mospërputhje mund të jetë nën-raportimi në anketën e vitit 1999. 1999 ka qenë kohë e jashtëzakonshme në Kosovë me shumë meshkuj jashtë, që ka rezultuar në nivele të ndryshme të raportimit të përdorimit të kontraktivëve nga gratë. Një anketë e mbajtur nga CARE në vitin 2003^{vi13} ka raportuar se 36% e të gjitha grave aktualisht përdornin një metodë moderne kontrceptive; prandaj rezultatet nga kjo anketë tregojnë një rritje edhe më të madhe të përdorimit të kontraktivëve nga gratë në moshën riprodhuese krahasuar me vitin 1999.

¹² Përqindja e grave të martuara që aktualisht përdorin kontraktivë për të shtyer ose parandaluar shtatëzaninë

¹³ Raporti vlerësues i praktikave të planifikimit të familjes, njohuritë dhe sjelljet CARE International Kosovë 2003

Raporti i CARE sygjeron se kjo rritje mund të jetë rezultat i programeve të shëndetit riprodhues të ndërmarra nga agjencitë e ndryshme gjatë viteve të kaluara.

6.4 Metoda e përzier kontraceptive

Metoda e përzier kontraceptive i referohet raportit të metodave specifike që shfrytëzuesit aktual janë duke përdorur. Kështu duke marrë gratë e martuara që përdorin kontraceptive si një grup i tërë, figura 6.1. paraqet se 32% e këtij grupi janë duke përdorur metodat tradicionale; ky mund të jetë reflektim i nivelit të kërkesave të paplotësuara për metoda moderne të kontraceptivëve.





Figura 6.2 paraqet përzierjen e metodave në mes të gjitha metodave moderne krahasuar me rezultatet nga anketa e vitit 1999. Nga të gjitha gratë që përdorin metodat moderne, IUD merr 22.1% e tregut dhe është aktualisht forma më e përdorur e metodës kontraceptive e përdorur nga gratë e martuara. Kjo është tipike për shtetet ish-komuniste; nën regjimet komuniste, IUD gjithmonë ka qenë formë shumë e promovuar e kontraceptivëve. Është interesante se përqindja e grave të martuara që përdorin pilula ka rënë për 6% që nga viti 1999. Metodatat, që kanë rritur pjesën e tyre të tregut janë kondomët dhe sterilizimi i femrave.



6.5 Përdorimi aktual për nga karakteristikat personale

Tabela 6.5 tregon se nivelet e përdorimit aktual të kontraceptivëve në mesin e grave të martuara ndryshojnë për nga karakteristikat personale. Shkalla kontraceptive e prevalencës në zonat urbane është më e lartë sesa në zonat rurale (67 dhe 50%). Pilulat janë metoda e vetme që ka përqindje më të madhe të përdorimit në zonat rurale krahasuar me ato urbane. Ndikimi i arsimimit në kontraceptivë është më i habitshëm. Siç tregon figura 6,3, në moshat 15-19 kur është parë edhe më herët se prevaleca kontraceptive ka mbetur relativisht e ultë, gratë me arsimim të mesëm ose të lartë ka gjasa më të mëdha të përdorin kontraceptivët sesa ato me arsimim elementar ose pa arsimim.




Tabela 6.5 Përdorimi aktual i kontraktivëve për nga karakteristikat personale

Shpërndarja në përqindje e grave të martuara për nga metoda kontraktive aktualisht e përdorur, në bazë të vendbanimit, etnitetit dhe arsimimit, Kosovë 2003

Moshë	Cilado metodë	Metodë moderne								Metodë tradicionale			Metodë tjetër	Numri i grave	Moshë	
		Cilado metodë moderne	Pilulë	IUD	Injektione	Kondom	Sterilizim i femrës	Diafragma	Shkumë/gell	Cilado metodë tradicionale	Abstenimi periodik	Tërheqja				
Vendbanimi																
Urban	66.8	45.4	6.4	21.1	7.0	8.0	1.2	0.9	0.8	60.9	4.2	56.7	0.0	33.2	1 453	
Rural	50.2	41.8	9.0	21.1	1.7	6.4	2.3	0.4	0.9	58.1	1.6	56.5	0.0	49.8	1 099	
Etniteti																
Shqipëtar	53.7	41.9	8.2	22.0	1.5	6.9	2.1	0.5	0.7	58.1	2.0	56.1	0.0	46.3	2 187	
Serb	62.5	37.6	2.7	18.1	0.0	11.0	0.0	2.2	3.6	62.2	6.8	55.4	0.3	37.5	285	
Tjetër	76.8	24.6	13.1	7.9	0.5	2.6	0.5	0.0	0.0	75.4	7.4	68.0	0.0	23.2	880	
Arsimimi																
Pa shkollë	41.3	36.5	12.3	23.4	0.0	0.0	0.8	0.0	0.0	63.5	1.6	61.9	0.0	58.7	93	
Shkollë fillore, ¹⁴	55.5	39.7	9.1	21.4	0.9	5.5	1.7	0.4	0.7	60.3	2.0	58.3	0.0	46.5	1 466	
Shkollë e mesme dhe e lartë ¹⁵	57.2	45.4	6.4	19.1	2.6	12.0	2.9	1.0	1.4	54.3	3.8	50.5	0.3	42.8	807	
Univerzitet. & më lartë	66.4	44.7	2.5	22.3	5.9	6.9	6.3	0.0	0.8	49.3	2.5	46.8	0.0	33.6	185	

6.6 Përdorimi aktual për nga gjendja e grave

Mundësia e gruas për të përdorur metodat kontraktive për të kontrolluar fertilitetin e saj ka gjasë të ndikohet nga gjendja e saj dhe shkalla e mundësive. Kush vendos për kontraktivët në partneritet, është një indikator i mundësisë së gruas dhe nëse ajo ka kontrollë të plotë për fertilitetin e saj. Kuptimi i vendimmarrjes në shtëpi është gjithashtu i dobishëm për zhvilluesit e politikës për të vendosur se kush duhet të vëhet në cak me qëllim të promovimit të kontraktivëve. Gratë në anketë janë pyetur nëse përdorimi i kontraktivëve ka qenë kryesisht vendim i tyre, burrave/partnerëve të tyre, ose vendim i përbashkët. Siç tregohet në tabelën 6.6 gati 80% e grave kanë raportuar se përdorimi i kontraktivëve ka qenë vendim i përbashkët në mes tyre dhe partnerëve të tyre. Pothuaj gati 20% e shfrytëzuesve të IUD kanë raportuar se partneri ose burri i tyre ka vendosur për përdorim të kësaj metode. Për të gjitha metodat e caktuara, në shkallë më të madhe meshkujt kanë vendosur rreth përdorimit të kontraktivëve sesa femrat.

¹⁴ Ky nivel përfshinë tri kategori të përgjegjes të dhëna në pyetësor: nën fillore 1-4, nën fillore 5-7, dhe me fillore të kryer

¹⁵ Ky nivel përfshinë katër kategori të përgjegjeve të dhëna në pyetësor: mesme 1-3, mesme 4 e mbi, gjimnaz dhe shkollë të lartë


Tabela 6.6 Vendimi për të përdorur kontraktivë						
Shpërndarja në përqindje e të gjitha grave për nga metoda e përdorur e kontraktivëve në bazë të vendimit për t'a përdorur.						
Vendimi për të përdorur për kontraktivë	Metoda					Numri i grave
	Të gjitha metodat	Pilulë	IUD	Kondom	Tërheqje	
Vet gratë	5.3	6.7	6.9	8.7	3.3	104
Burri/partneri	15.4	11.9	19.6	7.3	15.2	223
Së bashku	79.4	81.4	73.5	84.0	81.5	1381

Tabela 6.7 Vendimi për përdorimin e kontraktivëve për nga karakteristikat personale				
Shpërndarja e përqindjes së të gjitha grave që përdorin kontraktivë në bazë të vendimit të kujt përdoret, për nga karakteristikat e zgjedhura personale				
Karakteristika	Për të përdorur kontraktivë, është vendim i			Numri i grave
	Vet gruas	Burrit/partnerit	I përbashkët	
Mosha				
15-19		19.4	80.6	15
20-24	7.4	12.5	80.1	111
25-29	5.3	17.1	77.6	273
30-34	4.8	13.0	82.2	345
35-39	5.0	16.3	78.8	390
40-44	5.2	16.2	78.6	351
45-49	5.8	14.6	79.6	223
Vendbanimi				
Urban	3.4	9.4	87.3	1022
Rural	6.2	18.4	75.4	686
Gjendja martesore				
Beqar	59.8	24.3	15.9	31
Martuar	4.2	15.3	80.5	1674
Entiteti				
Shqipëtar	4.5	16.2	79.4	1434
Serb	19.9	6.9	73.2	203
Tjerë	4.1	10.0	85.9	71
Arsimimi				
Pa shkollë	1.5	31.9	66.6	54
Shkollë fillore	4.1	17.9	78.1	979
Shkollë të mesme & të lartë	7.6	8.6	83.8	614
Univerzitet & mbi	10.2	1.7	88.2	61

Tabela 6.7 tregon vendimin për përdorim të kontraktivëve për nga informatat personale. Vendimmarrja ndryshon me vendbanim, është interesant se në viset rurale pothuaj dyfishi i numrit të grave nga ato në zonat urbane marrin vet vendimet rreth përdorimit të kontraktivëve (3.4% dhe 6.2%). Sidoqoftë 18.4% e grave që jetojnë në viset rurale kanë raportuar se burrat/partnerët e tyre marrin vendimet rreth përdorimit të kontraktivëve krahasuar me 9.4% në zonat urbane. Pothuaj 60% e grave beqare kanë raportuar se përdorimi i kontraktivëve është vendim i tyre. Përfundimisht arsimimi duket të ketë ndikim në vendimmarrje lidhur me kontraktivët, pasi që niveli i arsimimit është kah zhvillohet, kështu edhe përqindja e grave që marrin vendimet e tyre rreth kontraktivëve dhe numri i grave që marrin vendimet së bashku me burrat ose partnerët e tyre.

6.7 Metoda e ushqimit me gji (LAM)

Duke ushqyer foshnjën me qumësht gjiri, nëna e re mund të parandaloj shtatëzaninë për gjer në gjashtë muaj nëse nuk është rivendosur cikli menstrual; kjo shpesh përdoret si formë e kontraktivit dhe është e njohur si LAM. Me qëllim që të kuptohet nëse gratë kosovare kanë njohuri për LAM, të gjitha gratë në anketë janë pyetur nëse shancat për të mbetur shtatëzënë janë rritur ose zvogëluar gjatë ushqimit me gji. Siç tregon figura 6.4, 64% e grave janë përgjegjur se ato nuk dijnë nëse të ushyerit me gji ka ndikim në shtatëzani, dhe 13% e grave mendojnë se dhënia e gjirit rrit rrezikun e shtatëzanisë. Prandaj LAM zakonisht nuk përdoret në Kosovë për të penguar shtatëzaninë.



6.8 Burimi i kontraktivëve

Informata për burimet e kontraktivëve modern është e dobishme për menaxherët dhe implementuesit e planifikimit familjar. Gratë që kanë raportuar se janë aktualisht duke përdorur metodë moderne të kontraktivëve janë pyetur kur ka qenë koha e fundit e përdorimit të metodës. Sektori publik është burimi kryesor i furnizimit me kontraktivë në Kosovë siç tregohet në tabelën 6.8, 56% e shfrytëzuesve të metodave moderne marrin metodën e tyre nga sektori publik. Qendrat shëndetësore qeveritare zënë furnizimin e 37% të tërë kontraktivëve modern.

Sektori privat duket se plotëson disa kërkesa për kontraktivë dhe thuhet se 30% e të anketuarve janë burim i tyre aktual. Burimi kryesor në sektorin privat janë doktorët privat. Kur hulumtohet burimi i furnizimit për metoda specifike dalin shumë ndryshime të mëdha. 43% e grave që përdorin kondomë i marrin ato nga jashtë institucionet medicinale, tipikisht kondomët mirren nga shokët ose të afërmit. Barnatoret luajnë rol të rëndësishëm në furnizimin e kontraktivëve orar, 22% e shfrytëzuesve aktual të pilulave kanë raportuar se kanë marrë pakon e tyre të fundit në barnatore.

<u>Tabela 6.8 Burimi i metodave moderne kontraktive</u>					
Shpërndarja në përqindjen e shfrytëzuesve aktual të metodave moderne kontraktive nga burimi i fundit i furnizimit, në bazë të metodave specifike, Kosovë 2003					
Burimi	Pilula	IUD	Kondom	Të gjitha metodat moderne	Numri i grave
Sektori publik					
Spitalet qeveritare	0.2	4.1	6.8	3.5	40
Qendrat shëndetësore qeveritare	43.6	43.9	10.0	37.2	363
Klinika për planifikim familjar	7.1	9.3	12.1	11.5	86
Klinika mobile /punëtor terreni	2.3	5.0	5.1	4.1	108
Sektori privat					
Spitale/klinika private barnatore	3.8	10.5	3.0	7.3	94
Doktor privat	22.1	1.7	11.4	8.2	72
	9.4	20.5	9.0	14.4	150
Burimet tjera					
Shok/i afërm	9.6	4.8	38.8	12.4	31
Institucion feje	2.0	0.0	0.0	0.8	5
Dyqan	0.0	0.1	3.9	0.4	784
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	1 733

6.9 Efektet e anësore të kontraktivëve

Përvoja e efekteve anësore dhe konsultimi shpesh mund të jenë relativisht reflektive në shkallat e mosvazhdimet. Të gjitha gratë që aktualisht përdorin një metodë moderne të kontraktivëve janë pyetur nëse ato kanë pasur ndonjë efekt anësor. Gratë pastaj janë pyetur nëse ato janë informuar nga punëtori shëndetësor rreth efekteve të mundshme anësore dhe nëse janë këshilluar çka të bëjnë në rast të paraqitjes së efekteve anësore. Siç tregohet në tabelën 3.5 pothuaj 12% e grave kanë raportuar paraqitjen e efekteve anësore të kontraktivëve. Mbi një e katërta e të gjithë shfrytëzuesve janë informuar rreth efekteve anësore dhe prej këtyre gati të gjithëve u është treguar çka të bëhet nëse dhe cilat efekte anësore paraqiten.

Tabela 6.9 Paraqitja e efekteve anësore te gratë që përdorin metoda kontrceptive		
	Shfrytëzuesit e kontrac.	Numri i grave
Efektet e paraqitura anësore me metodën aktuale	11.7	1 733
Treguar nga punëtori shëndetësor rreth efekteve anësore	26.4	1 727
Nëse u është treguar rreth efekteve anësore, u është treguar edhe çka të bëhet nëse efektet anësore i paraqiten	94.5	300

Kapitull 7: Çështjet e shëndetit riprodhues dhe shëndetësor


Në vitin 2003, janë shtruar disa pyetje sa i përket çështjes më të gjerë të shëndetit riprodhues të cilat nuk janë pyetur në anketën e vitit 1999. Ky kapitull përshkruan se ku gratë fitojnë dituri rreth planifikimit të familjes dhe me kend diskutojnë për planifikim të familjes. Gjithashtu përfshinë informatat për vizitat në kapacitetet shëndetësore nga të anketuarët për vehte ose fëmijët e tyre. Përfundimisht janë pyetur disa pyetje të gjitha grave të moshës në mes 15 dhe 49 vjeçare për të siguruar sjelljet dhe njohuritë e tyre rreth parandalimit të AIDS-it.

7.1 Planifikimi i familjes

Tabela 7.1 tregon përqindjen e moshës së grave të moshës riprodhuese që janë vizituar nga punëtorët e terrenit që kanë diskutuar me to rreth planifikimit të familjes. Numri i grave që janë vizituar është shumë i ultë, 3.5%. Prej grave të martuara, 4.3% janë vizituar dhe gratë që jetojnë në zonat urbane ka gjasa të jenë vizituar më shumë nga punëtorët e terrenit në krahasim me gratë që jetojnë në viset rurale.

Kanë diskutuar për planifikim të familjes në 12 muajt e kaluar	Të gjitha gratë	Gratë e martuara	Urban	Rural	Numri i grave
Me punëtorët të terrenit	3.5	4.3	4.1	3.2	4503
Me shokët, fqinjët ose të afërmit	33.9	47.3	40.2	31.6	4499

Gati 40% e grave kanë raportuar se kanë diskutuar për planifikim të familjes me shokët, fqinjët ose të afërmit. Prapë gratë urbane ka gjasa më të mëdha të kenë diskutuar këtë temë me shokët, fqinjët ose të afërmit sesa gratë fshatare (40.2% dhe 31.6%). Gratë që kanë diskutuar për planifikim të familjes me ndonjë person jo-mjekësor janë pyetur që të deklarojnë se kush ka qenë ai person, figura 7.1 tregon se 81.8% e grave që kanë diskutuar për planifikim të familjes, kanë diskutuar me burrat ose partnerët e tyre. Kjo tregon rëndësinë e ngritjes së vetëdijes dhe njohurisë për planifikim të familjes në mesin e burrave dhe grave.



7.2 Vizitat shëndetësore

Shërbimet e kujdesit shëndetësor në Kosovë kryesisht ofrohen nga një numër i institucioneve siç janë klinikat dhe spitalet. Struktura e Sistemit Primar të Kujdesit Shëndetësor përbëhet nga një qendër kryesore familjare për çdo komunë, gjithsej 30, dhe rreth tyre janë qendrat satelite familjare prej së cilave janë rreth 350 në tërë Kosovën.

Siç tregohet në tabelën 7.2, 47% e të gjitha grave kanë raportuar vizitat në institucion shëndetësor për vehte ose fëmijët e tyre gjatë 12 muajve të kaluar. Vizitat në institucionet shëndetësore tregojnë ndryshime të konsiderueshme për nga mosha dhe vendbanimi. Banorët urban ka gjasa më të mëdha të kenë vizituar institucionin shëndetësor sesa banorët e fshatit. Gratë mbi 25 ka gjasa më të mëdha të kenë vizituar institucionet shëndetësore sesa gratë më të reja, që ka gjasa të jetë për shkak se gratë më të reja edhe nuk kanë fëmijë.

Gjithashtu duket se ka një marrëdhënie në mes të arsimimit dhe vizitave në institucionet shëndetësore. Me ngritje të nivelit arsimor, ka korrespondencë të rritjes në raportin e grave që kanë raportuar vizitën në institucion shëndetësor. Për të qenë në gjendje që të spjegohen ndërlidhjet kyçe statistikore, anketa e ardhme për shëndetësi duhet të mbuloj aspektet tjera të institucioneve shëndetësore duke përfshirë shërbimet e ofruara dhe përmbushja e nevojave të klientëve, qasja në ato shërbime dhe perceptimi i njerëzve në mirëqenie.

Tabela 7.2 Vizitat shëndetësore		
Shpërndarja e përqindjes së grave që kanë vizituar një institucion shëndetësor për nga karakteristikat personale, Kosovë 2003		
Karakteristikat personale	Kanë vizitar një institucion shëndetësor	Numri i grave
Të gjitha gratë	47.4	4505
Mosha		
15-19	20.9	725
20-24	39.1	808
25-29	55.8	764
30-34	61.1	681
35-39	56.3	590
40-44	54.1	549
45-49	51.4	388
Vendbanimi		
Urban	54.9	2605
Rural	44.5	1900
Etniteti		
Shqipëtar	46.3	3934
Serb	69.5	427
Tjetër	75.8	144
Arsimimi		
Pa shkollë	46.1	139
Shkollë fillore	46.8	2425
Shkollë e mesme dhe e lartë	49.0	1798
Univerzitet ose më lartë	56.1	141

7.3 Informatat për shëndetin riprodhues nga burimet tjera

Edhe pse anketa nuk ka shtruar pyetjet për shumë aspekte të shëndetit riprodhues, ekzistojnë burime tjera të të dhënave ku mund të gjenden disa informata për këtë temë. Për shembull sistemi i riaktivizuar tani vonë i statistikave në Kosovë ka regjistruar se në vitin 2003^{vii}, 84% e të gjitha lindjeve janë bërë në spital/maternitet. Për të gjitha lindjet ku është regjistruar peshë e lindjes, 6.5% kanë peshuar nën 2.5 kilogram, që klasifikohet si peshë e ultë e lindjes. Raporti i kryer nga UNICEF-i në vitin 2003 i titulluar “Promovimi i kujesit gjatë-lindjes në Kosovë”^{viii} thotë se në vitin 2002 rreth 10% e lindjeve në spital kanë qenë me prerje cezariene. Raporti gjithashtu thotë se aktualisht numri i grave që janë në kujdes para lindjes është i ultë. Raporti tjetër që është përqëndruar vetëm në kujdesin para lindjes në Kosovë, thotë se kualiteti i kujesit gjatë vizitave para lindjes

mund të konsiderohet si e varfër me vetëm një të tretën e grave të anketuara që janë këshilluar për shtatëzaninë normale, ushqimin, komplikimet e mundshme gjatë shtatëzanisë dhe të ushqyerit me gji^{ix}.

7.4 HIV/AIDS në Kosovë

Në regjionin e Evropës lindore dhe Azisë qendrore, Programi i Kombeve të Bashkuara për AIDS (UNAIDS) ka llogaritur se në fund të vitit 2003 1.3 milion njerëz kanë qenë me HIV^x. HIV/AIDS është sëmundje pandemike sidoqoftë që ndryshon shumë në mes të zonave bile edhe të regjionit të njëjtë, në pajtim me sistemin e klasifikimit të UNAIDS-it, Kosova konsiderohet të ketë nivel të ultë epidemik me shkallë të prevalencës prej nën 0.1%. Rasti i parë i AIDS-it është raportuar në vitin 1986, që nga atëherë janë regjistruar edhe 58 raste të HIV/AIDS në Kosovë^{xi}. Mënyra e transmetimit është raportuar të jetë kryesisht përmes seksit heteroseksual. Mund të thuhet sidoqoftë se numri i personave që ende janë gjallë dhe jetojnë me HIV/AIDS mbetet shumë i panjohur në Kosovë.

7.5 Njohuria për HIV/AIDS dhe metodat e parandalimit të HIV-it

Informatat janë grumbulluar nga gratë e moshës riprodhuese nëse ato kanë dëgjuar për ndonjë sëmundje që quhet AIDS dhe nëse besojnë se ka mënyrë të parandalimit. Tabela 7.3 tregon përqindjen e grave, për nga karakteristikat personale, që kanë dëgjuar për AIDS-in. Afro 9 nga 10 gra e të gjitha karakteristikave personale kanë dëgjuar për AIDS-in me përjashtim të grave që kurrë nuk kanë qenë në shkollë. 13.4% e grave fshatare thonë se nuk dijnë për AIDS-in krahasuar me 3.6% e grave urbane, dhe gratë e reja që janë nën 30 ka gjasa më të mëdha të kenë dëgjuar për AIDS-in sesa ato më të vjetra.

Për të vlerësuar nivelin e njohurisë rreth HIV/AIDS, të anketuarit që kanë dëgjuar për infektim janë pyetur nëse ekziston diçka që personi mund të bëjë për t'i ikur infektimit me virus që shkakton AIDS-in. Të dhënat në tabelën 7.3 tregojnë se 90% e grave që kanë dëgjuar për AIDS-in besojnë se ekziston mënyra për t'a parandaluar. Edhe një herë, gratë në të tridhjetat, gratë në viset rurale, dhe gratë pa shkollë ka gjasa më të vogla të besojnë se ekziston ndonjë mënyrë e parandalimit të infektimit me HIV/AIDS.

<u>Tabela 7.3 Njohja për HIV</u>			
Shpërndarja në përqindje të grave që kanë dëgjuar për HIV/AIDS dhe nëse besojnë se ekziston ndonjë mënyrë e parandalimit të HIV/AIDS për nga karakteristikat personale, Kosovë 2003			
Karakteristikat personale	Ka dëgjuar për HIV/AIDS	Beson se ka mënyrë të parandalimit të HIV/AIDS	Numri i grave
Të gjitha gratë	89.5	90.2	4505

Tabela 7.3 Njohja për HIV			
Shpërndarja në përqindje të grave që kanë dëgjuar për HIV/AIDS dhe nëse besojnë se ekziston ndonjë mënyrë e parandalimit të HIV/AIDS për nga karakteristikat personale, Kosovë 2003			
Gratë e martuara	88.1	89.5	
Mosha			
15-19	91.4	91.5	725
20-24	93.8	90.8	808
25-29	91.4	91.9	764
30-34	86.1	92.4	681
35-39	88.1	90.3	590
40-44	86.2	82.9	549
45-49	86.1	88.0	388
Vendbanimi			
Urban	96.8	94.4	2605
Rural	86.6	88.3	1900
Etniteti			
Shqipëtar	88.9	90.1	3934
Serb	98.1	97.2	427
Tjerë	97.7	80.4	144
Arsimimi			
Pa shkollë	54.9	65.3	139
Shkollë fillore ¹⁶	87.5	88.4	2425
Shkollë e lartë dhe e lartë ¹⁷	98.0	95.0	1798
Univerzitet ose mbi	100.0	98.3	141

Nëse të anketuarët kanë raportuar se mund të parandalohet infektimi me HIV, ato janë pyetur për të treguar metodat e parandalimit. Kjo ka qenë pyetje e hapur dhe gratë janë mundësuar të tregojnë mjetet që ato dijnë, pa i ndihmuar. Tabela 7.4 tregon përqindjen e grave që në mënyrë spontane kanë përmendur mënyrat e veçanta për t'i ikur marrjes së HIV-it. Mjetet më së shpeshti të përmendura për parandalim të HIV/AIDS është përdorimi i kondomit, i përmendur nga 61% e grave. Përgjegjja e dytë e përmendur më së shpeshti është besnikëria ndaj një partneri. Kishte ndryshime të habitshme në përgjegjet në mes të grave të niveleve të ndryshme të arsimimit, ku me secilën ngritje në nivel të arsimit një pjesë më e madhe e grave në secilin grup arsimor ka raportuar strategji të veçanta të parandalimit të HIV-it (me përjashtim të parandalimit të transfuzionit të gjakut, injektiveve dhe puthjes). Një pjesë e vogël e grave si strategji tjera të parandalimit kanë përmendur programet informative, arsimore dhe komunikuese (IEC) që kërkohen për të zgjeruar njohuritë te gratë.

¹⁶ Ky nivel përfshinë tri kategori të përgjegjes të dhëna në pyetësor: nën fillore 1-4, nën fillore 5-7, dhe me fillore të kryer

¹⁷ Ky nivel përfshinë katër kategori të përgjegjeve të dhëna në pyetësor: mesme 1-3, mesme 4 e mbi, gjimnaz dhe shkollë të lartë

Tabela 7.4 Njohuria e mënyrave për të parandaluar HIV-in

Në mesin e grave që kanë dëgjuar për përqindjen e AIDS-it të metodave të veçanta të njohura për të parandaluar infektimin me HIV, Kosovë

Karakteristikat personale	Mënyrat për të parandaluar HIV/AIDS								Numri i grave
	Abstenimi nga seksi	Përdorimi i kondomit	Besnikëria ndaj partnerit	Parandalimi i seksit me persona që kanë pasur shumë partnerë	Parandalimi i seksit me personat që injektojnë droga intravenoze	Parandalimi i transfuzionit të gjakut	Parandalimi i injeksioneve	Parandalimi i puthjes	
Të gjitha gratë	10.9	61.2	54.7	32.1	26.3	5.6	6.7	3.1	3946
Gratë e martuara	11.2	63.3	53.0	34.3	27.3	5.9	6.8	3.7	
Mosha									
15-19	19.8	64.1	50.7	34.6	28.3	6.9	6.7	6.0	637
20-24	18.0	68.1	53.9	40.8	31.9	7.2	7.2	2.6	723
25-29	13.9	63.6	52.6	32.5	23.6	5.8	6.3	4.7	692
30-34	17.4	65.3	54.6	33.5	27.7	4.4	6.2	3.0	598
35-39	21.9	64.8	54.5	32.1	28.2	6.9	10.2	4.2	509
40-44	22.4	56.8	52.5	31.6	25.6	2.7	5.0	2.0	463
45-49	16.4	52.2	49.8	30.9	22.5	6.5	5.3	1.9	324
Vendbanimi									
Urban	16.7	69.7	55.8	37.7	30.9	6.6	7.6	3.8	2402
Rural	19.2	60.5	51.7	32.8	25.7	5.6	6.5	3.7	1544
Etniteti									
Shqipëtar	17.4	63.8	52.9	34.5	27.3	5.7	7.3	3.9	3417
Serb	31.3	70.6	69.6	38.2	38.7	6.3	0.6	1.8	410
Tjerë	28.6	38.2	30.6	21.4	10.3	12.5	2.7	0.7	119
Arsimimi									
Pa shkollë	11.2	46.8	37.8	17.6	9.6	4.5	8.5	9.2	80
Shkollë fillore	16.5	50.7	44.4	27.3	21.8	5.1	5.9	3.3	2013
Shkollë e lartë dhe e lartë	17.4	72.4	55.2	39.5	31.6	6.2	6.5	3.1	1714
Univerzitet ose mbi	17.7	76.6	74.8	50.4	40.2	2.2	9.5	4.0	139

Kapitull 8: Migrimi

Ky kapitull paraqet informatat e grumbulluara nga anketa lidhur me aspektet e migrimit të popullsisë. Migrimi është një fenomen i ndryshëm nga karakteristikat tjera demografike. Konceptet e lindjeve ose vdekjeve kuptohen lehtë dhe matjet e tyre janë në konformitet me kriteret e pranuar ndërkombëtarisht. Migrimi sidoqoftë duhet të definohet më veçanërisht në secilin kontekst ku përdoret. Njerëzit për nga natyra janë të lëvizshëm dhe lëvizja për shumë arsye është pjesë e jetës së përditshme. Migrimi prandaj duhet të definohet në kontekst të kohës së veçantë dhe vendit të veçantë. Migrimi, veçanërisht migrimi i brendshëm, pasi që të definohet në mënyrë unike për shtetin e caktuar, nuk mund të përshtatet krahasimeve ndërkombëtare.

Ka shumë interesim dhe spekulime që rrethojnë temën e migrameve ndërkombëtare në Kosovë, por ende numri i personave që kanë lëshuar vendin dhe janë kthyer pas luftës së vitit 1999, është i panjohur. Zakonisht informatat për migrimin vijnë nga regjistrimi ose sistemi vital statistikor i shtetit. Regjistrimi i fundit në Kosovë është mbajtur në vitin 1991 (por është bojkotuar nga disa pjesë të popullsisë) dhe VSS i Kosovës aktualisht regjistron vetëm informatat për lindjet, vdekjet, martesat dhe shkurorëzimet. Prandaj të dhënat tjera që nuk janë nga anketa, siç këto të paraqitura këtu, janë pak të besueshme sa i përket migrimit në Kosovë.

8.1 Migrimi i brendshëm

Anketa merr dy qasje pak të ndryshme për të matur migrimin e brendshëm. I pari merr në konsideratë njerëzit që kanë jetuar në vende të ndryshme në kohën e lindjes gjer në vendbanimin e përhershëm në datën e anketimit. Kjo shpesh quhet edhe migrimi për jetë. Për personat që konsiderohen migrues për jetë, ata duhet tani të jetojnë në regjion tjetër nga regjioni ku janë lindur. Vëreni se personat që janë larguar nga regjioni i tyre i lindjes dikur në të kaluarën por janë kthyer, nuk konsiderohen si migrues për jetë. Përveç lëvizjes së fundit, lëvizjet e shumta brenda Kosovës nuk mirren parasysh dhe personat e lindur jashtë vendit që tani jetojnë në Kosovë nuk janë përfshirë në analizën strikte të migrameve të brendshme, por ndonjëherë paraqiten në tabela për informata shtesë.

Qasja e dytë bazohet në pyetjet rreth vendbanimit të përhershëm saktësisht pesë vite para anketës. Secili person që tani jeton në një regjion tjetër nga ai ku ka jetuar saktësisht pesë vite më parë, konsiderohet migrues gjatë kësaj periudhe. Vëreni se sikur edhe te vendlindja, nuk përfshihen migruesit e shumëfishtë dhe ata që janë kthyer nga jashtë. Sidoqoftë, pyetja mbulon vetëm personat që tani janë pesë vjeçar e mbi.

8.1.1 Migruesit për jetë

Migrimi për jetë i bazuar në vendin e lindjes është shumë i dobishëm për disa qëllime. Merita e saj kryesore qëndron në definimin që përshkruan migruesin që ka migruar nga vendi i lindjes në çfarëdo kohe gjatë jetës së tij ose saj. Kjo ofron definim shumë të dobishëm sociologjik të migruesit sa i përket të gjithë personave që vijnë nga jashtë zonës së destinimit si migrues, pa marrë parasysh kohën e lëvizjes së tyre.

Një nga mangësitë e përdorimit të të dhënave për migrim për jetë është se koha e migrimit nuk është shumë precize. Mund të vështrohen vetëm efektet përfundimtare të migrimit. Tabela 8.1 tregon numrin e personave që kanë hyrë ose dalë nga regjioni gjatë jetës së tyre. Në kolonën e fundit, tabela tregon llogaritë e nxjerra të migrimit të pastër, duke mundësuar paraqitjen se cilat regjionet fitojnë e cilat humbin nga procesin i migrimit për jetë.

Krejtësisht rreth 5% e të anketuarve janë migrues për jetë, që kanë lëvizur në regjionin e tyre aktual ku banojnë. Përveç kësaj, gati 28 mijë të anketuar thojnë të kenë lindur jashtë.

Regjioni i lindjes	Migruesit hyrës	Migruesit dalës	Migrimi përfundimtar
Gjakova	4900	14,300	-9400
Gjilan	4700	14,100	-9400
Mitrovica	9600	16,300	-6700
Peja	16,000	8200	+7800
Prizren	6400	11,800	-5400
Pristina	36,600	14,100	+22,500
Ferizaj	10,600	10,000	+600
Jashtë	27,800

